



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Qeverisja dhe Politikat Publike”**

ofruar nga

“Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. PhD. Dorianë Pano
2. PhD. Eglantina Farruku

Shtator/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike” ofruar
nga “Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Shkencave
Politike”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike (Fakulteti i Shkencave Sociale)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 881, date 128.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH Nr. 297, date 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Një vit akademik/2 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 PAE 16 PAK 34 2023-2024 PAE 17 PAK 30
18	Numri i studentëve:	2022-2023 20 studentë 2023-2024 11 studentë
19	Komente / të tjera:	-


PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Qeverisja dhe Politikat Publike” është ofruar nga Universiteti i Tiranës në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 881, datë 12.08.2009. Ky program zhvillohet në një vit akademik dhe mbart 60 kredite ECTS. Struktura dhe përmbajtja e tij janë hartuar në funksion të kërkesave aktuale për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e qeverisjes dhe politikave publike, me synim formimin e specialistëve të aftë të kontribuojnë në modernizimin e administratës publike dhe në proceset e integritetit evropian.

Gjatë këtij programi, studentët pajisen me dije të thelluara në lidhje me mënyrën e funksionimit të institucioneve shtetërore, proceset e analizës dhe hartimit të politikave, menaxhimit e burimeve publike dhe implementimin e strategjive zhvillimore. Programi synon gjithashtu të forcojë kapacitetet analitike dhe aftësitë praktike të studentëve në fushat e vlerësimit të politikave dhe përdorimit të metodave të kërkimit shkencor, duke promovuar gjithnjë një qasje kritike dhe profesionale ndaj sfidave të qeverisjes.

Përmes literaturës bashkëkohore, leksioneve nga profesionistë të fushës dhe angazhimit në projekte kërkimore, studentëve u krijohet mundësia të njihen me përvojat më të mira ndërkombëtare dhe të përgatiten për të dhënë kontribut konkret në hartimin dhe zbatimin e politikave publike në vend. Krahas përgatitjes akademike, theksi vendoset në zhvillimin e kompetencave për mendim strategjik, aftësi komunikimi dhe zgjidhje problemesh.

Në përfundim të programit, studentët pajisen me një diplomë që u ofron mundësi të gjera punësimi në administratën publike, organizata jofitimprurëse, institucione ndërkombëtare, media, parti politike, si dhe në sektorin privat. Kjo diplomë synon të kontribuojë drejtpërdrejt në krijimin e një administrate më efikase, transparente dhe me standarde të larta profesionale.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u formua dhe u trajnuar në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara nga ASCAL, me qëllim vlerësimin e programit të studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” të ofruar nga Departamenti i Shkencave Politike, Fakulteti i Shkencave Sociale.

Procesi i vlerësimit përfshiu shqyrtimin e dokumentacionit të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe realizimin e vizitave në institucion me dt.28-29 Janar, 2025. Ekspertët e jashtëm të angazhuar në këtë proces ishin Dr. Doriana Pano dhe Dr. Eglantina Farruku, të cilët u asistuan gjatë gjithë procedurës nga përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Denisa Bogdani.

Gjatë procesit të vlerësimit, GVJ ka përdorur katër nivele për të vlerësuar përmbushjen e standardeve të programit të studimit: (1) standardet nuk përmbushen, (2) standardet përmbushen pjesërisht, (3) standardet përmbushen kryesisht, dhe (4) standardet përmbushen plotësisht. Vlerësimi është realizuar përmes takimeve të drejtpërdrejta me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale, Drejtuesin e Departamentit të Shkencave Politike, stafin akademik dhe studentët e këtij masteri, NJSBC, zyrën e këshillimit të karrierës, zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e marrëdhënieve me jashtë, Erasmus+ dhe të projekteve, sekretarinë mësimore dhe bibliotekën.

Për realizimin e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve për riakreditimin e programeve të studimit, GVJ ka mbështetur procesin në ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë në Shqipëri, si dhe në informacionin e marrë nga takimet dhe dokumentacionin e ofruar nga institucionet. Gjatë vizitës, GVJ ka kërkuar dhe shqyrtuar dokumentacion shtesë për të pasur një pamje të plotë dhe të detajuar mbi performancën e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të të gjitha të dhënave dhe informacionit të mbledhur, është hartuar një raport i vlerësimit të jashtëm, i cili është dërguar për shqyrtim nga institucionet përkatëse. Pas marrëdhënies së komenteve dhe sugjerimeve nga institucionet, raporti ka marrë formën e tij përfundimtare. Ky proces ka pasur si qëllim të ofrojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv të cilësisë së programit të studimit, duke ofruar gjithashtu rekomandime për përmirësimin e tij dhe rritjen e standardeve të arsimit të ofruar.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.07.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 22/36 Prot., datë 28.09.2025 dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, me shkresë zyrtare Nr. 2419/3 Prot., datë 08.08.2025, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 09.08.2025.


GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me objeksionin dhe sqarimet për vlerësimin e standardit IV.1 kriteri 1,



Në lidhje me konstatimin e bërë në draft-raportin e vlerësimit të jashtëm, sipas të cilit GVJ ka cilësuar se gjatë vitit akademik 2022–2023 programi i studimit në fjalë ka në përbërjen e tij 1 staf akademik me Master Shkencor si personel akademik efektiv dhe në vitin akademik pasardhës 2023-2024 ka 2 personel akademik efektiv me Master Shkencor, theksojmë që GVJ i është referuar Tabelës 7, “Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 7), fq. 10”. Nga verifikimi i bërë bazuar në komentet e institucionit, rezulton që plotësimi i tabelës nuk është bërë për programin e studimit siç edhe mban titullin. Për këtë arsye GVJ iu referua tabelës 6.3, fq.10, për vitet akademike përkatëse, lidhur me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit në fjalë, nga ku rezulton që nuk ka të angazhuar asnjë personel akademik efektiv me Master Shkencor ndryshe nga çfarë është konstatuar fillimisht në draft-raportin e dërguar në institucion nga GVJ. Sa më sipër GVJ, bazuar në komentin e GVB, por edhe në rishqyrtimin e përmbajtjes tabelore referuar tabelës nr. 6.3, gjen me vend të pranojë komentin e ardhur nga IAL duke e reflektuar edhe në raport me ndryshimet përkatëse sipas të dhënave të sakta të tabelës së sipërcituar. Për sa më sipër **GVJ pranon komentin, raporti në këtë pikë ndryshon.**

- 2. GVJ konsaton gjithashtu se në Standartin VI.1 kriteri 2, ka bërë një lapsus lidhur me përshkrimin e këtij kriteri në Draft-RVJ-në e dërguar në institucionin tuaj. Llogaritja e ngarkesës mësimore për stafin akademik PAE dhe PAK është bërë saktësisht bazuar në të dhënat e tabelës 12, fq. 14, por ka një mospërputhshmëri me përshkrimin e këtij kriteri. GVJ thekson se për shkak të këtij lapsusi ku llogaritja e përqindjeve është e saktë por nuk e ka reflektuar në përshkrim, ka bërë ndryshimet përkatëse në përshkrim, referuar %-ve të llogaritura sipas “Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabela 12), fq 14”. Për këtë arsye, duke qenë se institucioni nuk përmbush masën 70% të ngarkesës mësimore për personelin akademik efektiv, përmbushja e standartit mbetet kryesisht.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Për Programin e studimit Master Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike” ofruar nga “Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Shkencave Politike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” përmbush plotësisht kriteret e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, duke mos u ndeshur me interesat kombëtare. Ky program ofron njohuri të thelluara dhe praktike në fushën e qeverisjes dhe politikave publike, duke kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale në vend. Përmes lëndëve të tilla si “Europianizimi i Administratës Shqiptare” dhe “Etika e Shërbimit Publik”, ai integron vlerat evropiane dhe kombëtare, duke mbështetur integrimin evropian dhe qeverisjen e mirë. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit për Masterin Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke u fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale në fushën e qeverisjes dhe politikave publike. Ky program synon të rrisë cilësinë e administratës publike dhe të mbështesë zhvillimin e vendit, duke pasqyruar fushën e veprimtarisë së institucionit në arsimin e lartë dhe zhvillimin profesional. Përmes lëndëve të tilla si “Imazhi i Institucioneve Publike” dhe “Qeverisja Lokale”, programi ofron njohuri të thelluara dhe praktike, duke kontribuar në realizimin e misionit institucional për të zhvilluar liderë të suksesshëm në sektorin publik. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i>

	<i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me strategjinë për zhvillim, Statutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe fushat e drejtimet akademike të tij. Programi reflekton qëllimin e institucionit për të avancuar njohuritë dhe aftësitë në qeverisje dhe politika publike, duke u fokusuar në përgatitjen e liderëve të aftë për të adresuar sfidat komplekse të administratës publike. Përmes kombinimit të teorisë, praktikës dhe kërkimit shkencor, ai mbështet vizionin institucional për zhvillimin profesional dhe akademik në sektorin publik, duke kontribuar në mënyrë aktive në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe kombëtare. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	N/A
Konkluzione	GVJ vlerëson se Programi Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesat kombëtare dhe prirjet globale të zhvillimit. Ai mbështet modernizimin e administratës publike dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale në Shqipëri, duke kontribuar në realizimin e objektivave kombëtare për një qeverisje moderne dhe të qëndrueshme. Programi gjithashtu integron vlerat evropiane dhe kombëtare, duke promovuar koordinimin efektiv të politikave publike dhe transparencën. Në përgjithësi, ky program është një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e qeverisjes efektive dhe transparente në Shqipëri.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësishë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni demonstroi përvojë të konsoliduar akademike në fushën e shkencave politike dhe administratës publike, duke pasur një staf akademik me kualifikime të përshtatshme shkencore dhe profesionale, përfshirë doktoratura dhe përvojë praktike në fushën e qeverisjes dhe politikave publike. Departamenti disponon kapacitete të mjaftueshme për mbështetjen e programit, si në aspektin e infrastrukturës fizike (auditore, biblioteka, akses në burime elektronike), ashtu edhe në aspektin e mbështetjes institucionale dhe administrative. Lëndët mbulohen nga staf me eksperiencë të mëparshme në mësimdhënie dhe kërkime në fushën përkatëse, duke garantuar kështu cilësinë dhe qëndrueshmërinë e programit. Gjithashtu, lidhjet me aktorë të administratës publike dhe institucione të politikbërjes përbëjnë një vlerë të shtuar për përgatitjen profesionale të studentëve. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 4.4 Te dhena tabelore per personelin akademik te programit</i> <i>Evidenca 4.11 CV e personelit akademik</i> <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësishë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike” është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësishë kryesore përgjegjëse për programin. Ky program është zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Politike, i cili ka një bazë të fortë akademike dhe profesionale në fushën e qeverisjes dhe politikave publike. Programi ofron njohuri të thelluara në administratën shqiptare dhe evropiane, duke përfshirë lëndë të tilla si “Administrata Shqiptare”, “Administrata e BE-së” dhe “Europianizimi i Administratës Shqiptare”. Përputhja e fushës së programit me klasifikimin dhe kodifikimin kombëtar dhe evropian është e qartë, duke pasqyruar sistemin e Bolonjës dhe duke ofruar një kurrikul të integruar me 60 kredite. Ky program mbështet zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe akademike në sektorin publik, duke kontribuar në realizimin e objektivave kombëtare

	për një qeverisje moderne dhe të qëndrueshme. <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 4.1 Plan i mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve.</i> <i>Evidenca 4.5 Informacion per kerkimin shkencor ne nivel departamenti</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi master profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike” është i pozicionuar brenda fushës së shkencave politike dhe administratës publike, dhe përputhet në mënyrë të qartë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse, që është Departamenti i Shkencave Politike. Programi trajton tema që lidhen me qeverisjen, proceset vendimmarrëse, hartimin dhe zbatimin e politikave publike, të cilat janë pjesë integrale e profilit akademik të njësisë. Në rast se në program përfshihen edhe elementë nga fusha të tjera (si ekonomia, e drejta apo menaxhimi publik), ato shërbejnë si mbështetje për objektivat kryesore të programit, pa e larguar atë nga përqendrimi i vet bazë. Për rrjedhojë, përputhshmëria me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë është e dukshme. <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.1 Plan i mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Programi master profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike, që përbën njësinë themelore akademike në përputhje të plotë me drejtimin e programit, ndaj nuk konsiderohet si program jashtë profilit të institucionit. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme përfshirja e institucioneve partnere për garantimin e cilësisë. Megjithatë, programi përfiton nga bashkëpunime akademike dhe profesionale me institucione publike dhe organizata partnere, të cilat e pasurojnë anën praktike dhe profesionale të formimit të studentëve, por pa qenë thelbësore për përmbushjen e standardeve akademike. Në këtë kontekst, cilësia e programit garantohej nga kapacitetet e vetë institucionit. <i>Evidenca 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation</i>
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e	Institucioni i arsimit të lartë ka ndërmarrë disa hapa drejt ofrimit të trajnimeve profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar, duke

diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	zhvilluar aktivitete të karakterit praktik, trajnime të shkurtra dhe seminare tematike në bashkëpunim me institucione publike dhe organizata të sektorit civil. Megjithatë, ofrimi i këtyre trajnimeve nuk është i formalizuar në një strukturë të qëndrueshme apo strategji të qartë të bashkërenduar me punëdhënësit. Në rastin e programit “Qeverisja dhe Politikat Publike”, është evidentuar një potencial i lartë për zhvillimin e bashkëpunimeve të tilla, për shkak të natyrës praktike të programit dhe lidhjes me sektorin publik, por këto përpjekje mund të intensifikohen dhe institucionalizohen më tej për të ndërtuar një urë të qëndrueshme mes diplomimit dhe përgatitjes për tregun e punës. Për këtë arsye GVJ rekomandon që <i>Institucioni të zhvillojë dhe formalizojë një plan për trajnime profesionale pas diplomimit, në bashkëpunim me punëdhënësit nga administrata publike dhe organizatat partnere, duke u bazuar në nevojat reale të tregut të punës dhe duke mundësuar vazhdimësi në zhvillimin profesional të të diplomuarve.</i> <i>Evidenca 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation</i> <i>Evidenca 3.17 Lista e marrëveshjeve për praktiken profesionale</i> <i>Evidenca 4.10 Format inovative të mesimdhënis</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se Programi master profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Politike, është ndërtuar në përputhje me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë bazë përgjegjëse dhe mbështetet në një përvojë të qëndrueshme institucionale në fushën e shkencave politike dhe administratës publike. Fusha e programit është në harmoni me klasifikimin kombëtar dhe evropian të fushave të studimit. Kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore janë të mjaftueshme për garantimin e cilësisë së programit, ndërsa përfshirja e elementeve ndërdisiplinore është e kontrolluar dhe nuk çënon përqëndrimin kryesor të studimeve. Megjithëse nuk bëhet fjalë për një program jashtë profilit të institucionit, bashkëpunimet me aktorë të jashtëm profesionalë dhe institucionalë e pasurojnë programin dhe ofrojnë mundësi për përvojë praktike të studentëve. Në drejtim të mbështetjes pas diplomimit, janë vërejtur përpjekje për organizimin e trajnimeve profesionale, megjithatë ky aspekt mbetet ende i fragmentuar dhe mund të përmirësohet përmes një strukture të dedikuar në bashkëpunim me punëdhënësit. Në përmbledhje, programi ofron një bazë të qëndrueshme për përgatitjen profesionale të studentëve në fushën e qeverisjes dhe politikave publike, me potencial për zhvillim të mëtejshëm në aspektin e ndjekjes së karrierës dhe bashkëpunimit me tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni ka ndërtuar një model funksional të bashkëpunimit të brendshëm për hartimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e programit master profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike”. Ndarja e detyrave ndërmjet njësive bazë (Departamentit të Shkencave Politike), strukturave drejtuese dhe stafit akademik është e qartë dhe reflekton ndarje të përcaktuar të përgjegjësisë, koordinim efektiv dhe diskutim i vazhdueshëm mbi përmbajtjen, realizimin dhe përmirësimin e programit. Gjithashtu, ka evidenca për angazhim në analiza të brendshme të performancës dhe mbledhje të feedback-ut nga aktorët përkatës, duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit institucional. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 2.5. Struktura organizative e FSHS 2024</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.4 Te dhena tabelore për personelin akademik të programit</i> <i>Evidenca 3.11 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit</i> <i>Evidenca 3.12 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Bashkëpunimet e institucionit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të biznesit dhe të sektorit publik, përbëjnë një aspekt pozitiv që kontribuon ndjeshëm në përmbushjen e objektivave formues të studentëve. Këto bashkëpunime nxisin ndërthurjen e njohurive teorike me praktikën, zhvillojnë kompetenca profesionale dhe ndërdisiplinore, si dhe lehtësojnë përfshirjen e aktorëve të jashtëm në procesin mësimor përmes leksioneve, praktikave dhe projekteve të përbashkëta. GVJ konstatoi që këto marrëdhënie janë të formalizuara, të dokumentuara dhe të integruara në mënyrë të qëndrueshme në strukturën e programit, duke pasur objektiva të qarta në cilësinë e programit dhe përvojën studentore. <i>Evidenca 4.3 Paketa e praktikës për programin e studimit</i> <i>Evidenca 3.17 Lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Në kuadër të realizimit të programit të studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike”, institucioni demonstroi një angazhim të qëndrueshëm në ndërtimin e partneriteteve me institucione, institute kërkimore dhe kompani të fushës, përmes marrëveshjeve të posaçme që mbështesin zhvillimin e praktikave profesionale dhe kërkimeve shkencore. Këto bashkëpunime janë të rëndësishme për garantimin e përfshirjes aktive të

praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	studentëve në kontekste reale të punës, duke ndihmuar në zhvillimin e kompetencave praktike dhe përgatitjen për tregun e punës. Gjithashtu, përfshirja e punëdhënësve në mbikëqyrjen e praktikave, si dhe angazhimi në nisma kërkimore dhe mobilitet akademik, përbën një vlerë të shtuar për cilësinë e programit. Këto marrëveshje janë të dokumentuara dhe kanë qëllime konkrete, duke siguruar ndërlidhjen e vazhdueshme të programit me tregun e punës dhe komunitetin profesional. <i>Evidenca 4.3 Paketa e praktikës për programin e studimit</i> <i>Evidenca 3.17 Lista e marrëveshjeve për praktiken profesionale</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” harton raporte analitike që vlerësojnë përfitimet e marra nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programit. Këto raporte shërbejnë si mjet monitorimi dhe vlerësimi të efektivitetit të bashkëpunimeve me institucionet partnere, duke identifikuar ndikimin e tyre në zhvillimin e praktikave profesionale, kërkimit shkencor, mobilitetit të studentëve dhe stafit, si dhe përmirësimit të përvojës mësimore. Ky proces reflektues ndihmon në rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit, duke siguruar që bashkëpunimet të jenë të orientuara drejt rezultateve konkrete dhe të dobishme për studentët dhe institucionin. <i>Evidenca 4.3 Paketa e praktikës për programin e studimit</i> <i>Evidenca 3.17 Lista e marrëveshjeve për praktiken profesionale</i> <i>Evidenca 3.19 Raport analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” demonstroi një angazhim të qartë për ndërlidhjen me aktorët institucionalë dhe profesionalë, brenda dhe jashtë vendit, përmes marrëveshjeve të formalizuara bashkëpunimi. Këto bashkëpunime sigurojnë zhvillimin e praktikave profesionale, përfshirjen në projekte kërkimore, mobilitetin akademik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përvojës studentore. Institucioni garanton monitorimin e rregullt të efektivitetit të këtyre bashkëpunimeve përmes raporteve analitike, duke reflektuar mbi përfitimet dhe duke orientuar programin drejt përmirësimit të vazhdueshëm dhe përafrimit me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në fushën e qeverisjes dhe politikave publike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit të Masterit Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike” është plotësisht në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke siguruar një strukturë të qartë dhe të standardizuar për vlerësimin e studentëve. Ky program realizohet brenda një viti akademik, me ngarkesë mesimore prej 60 kreditesh, e cila ndahet në dy semestra dhe ka një total prej 30 javësh mësimor. Gjatë vitit akademik, mund të zhvillohen deri në 6 orë mësimore çdo ditë, ndërsa studenti nuk zhvillon më shumë se 25 orë mësimore në javë. Koha e fillimit dhe përfundimit të mësimave, sesionet e provimeve, pushimet e dimrit dhe ato të festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik, i cili miratohet çdo vit. <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi ka për qëllim zhvillimin e aftësive të veçanta në një gamë të gjerë profesionale dhe specialitetesh, duke ofruar njohuri të avancuara në një fushë specifike studimi ose punësimi. Ai nxit një kuptim kritik të teorive dhe parimeve akademike dhe përgatit studentët për të zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara që janë thelbësore për trajtimin e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushat e tyre të specializuara. Ky program kontribuon në përgatitjen e studentëve për sfida profesionale, duke rritur aftësitë e tyre praktike dhe teorike për të adresuar çështje të avancuara dhe për të siguruar një ndikim të rëndësishëm në fushat përkatëse. <i>Evidenca 3.6 Rrregullorë e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” ka përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse, të cilat janë në përputhje të plotë me kërkesat e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo strukturë siguron që studentët të zhvillojnë aftësi praktike të lidhura ngushtë me profesionin dhe të përfundojnë detyrimet përmbyllëse që vlerësojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë programit. Raporti i lëndëve është në përputhje me VKM Nr. 41 dhe specifikon kategoritë e krediteve: Kategoria D (praktika) përfshin 6 kredite, që janë 10% e numrit total të krediteve (60), dhe Kategoria E (detyrime përmbyllëse) përfshin 10 kredite, që janë 16.6% e numrit

	total të krediteve, në përputhje me kërkesat e VKM-së për këto kategori.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i ciklit të dytë Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike” ofrohet nga Departamenti i Shkenca Politike, pjesë e Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, një institucion publik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion funksionon në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë, konkretisht Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nuk gëzon status të veçantë apo të diferencuar nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend. Të gjitha procedurat e administrimit, organizimit, drejtimit dhe sigurimit të cilësisë për këtë program zbatohen sipas standardeve dhe rregulloreve të përgjithshme të aplikuar për institucionet publike të arsimit të lartë në Shqipëri. Kjo garanton që programi të jetë i integruar brenda sistemit të unifikuar të arsimit të lartë, pa privilegje apo trajtim të veçantë ligjor ose institucional.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	N/A
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria	Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike është kodifikuar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke përdorur kodin përkatës të programit në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit. Sa i përket kodifikimit të lëndëve, institucioni ka ndjekur

përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	procedurën zyrtare dhe ka depozituar pranë Ministrisë propozimet për kodifikimin individual të lëndëve të këtij programi, në përputhje me udhëzimet dhe afatet e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi. Megjithatë, në momentin e hartimit të këtij raporti, institucioni nuk ka marrë ende përgjigje zyrtare nga autoritetet përkatëse për kodet individuale të lëndëve. Për pasojë, në planin mësimor aktual, lëndët janë të listuara vetëm me emrat, ngarkesën, kreditet dhe semestrin përkatës, por pa kode të veçanta identifikuese. Institucioni mbetet në pritje të miratimit zyrtar të kodifikimit të lëndëve, në mënyrë që të plotësojë në mënyrë të plotë kërkesat ligjore dhe administrative për transparencë, menaxhim akademik dhe përputhshmëri me standardet e arsimit të lartë në Shqipëri.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit ofrohet në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore, si pjesa e përket organizimit të programit, ndarjes në ECTS, ashtu edhe për kriteret e pranimi. Kjo siguron një strukturë të qartë dhe të disiplinuar të programit, duke mundësuar që ai të përmbushë standardet akademike dhe ligjore të kërkuara. Për më tepër, përputhshmëria me këto kriteret garanton cilësinë dhe integritetin e programit, duke siguruar një përgatitje të qëndrueshme dhe të mirëstrukturuar për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Sociale, nëpërmjet strukturave të tij drejtuese dhe njësive përbërëse, garanton zbatimin e akteve ligjore, nënligjore dhe rregulloreve në fuqi. Informimi i vazhdueshëm dhe zbatimi korrekt i këtyre akteve nga të gjitha njësitë përbërëse sigurohet nëpërmjet mekanizmave institucionalë. Në këtë kontekst, Departamenti i Shkencave Politike, në përputhje me Rregulloren e Fakultetit, mban përgjegjësinë e drejtimit dhe koordinimit të procesit të hartimit dhe zhvillimit të kurrikulave për të gjitha ciklet e studimit që ai mbulon. Kjo qasje synon harmonizimin e përmbajtjes akademike me nevojat e tregut të punës dhe objektivat e zhvillimit institucional.

	Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” zhvillohet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Departamentit të Shkencave Politike, i cili angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në sigurimin e standardeve akademike dhe organizimin efektiv të procesit mësimor, administrativ dhe financiar. Përveç garantimit të cilësisë akademike, departamenti monitoron ecurinë e programit dhe ndërmerr masa për përmirësimin e vazhdueshëm të tij, duke u mbështetur në një proces vendimmarrjeje kolegjiale. Për vitin akademik 2022-2023, në këtë departament kontribuoi një trupë akademike e përbërë nga: • Stafi PAE: 3 pedagogë me titullin Prof. Dr., 2 me titullin Prof. Assoc. Dr., 10 me titullin Dr., dhe 1 pedagog me titullin M.Sc.; • Stafi PAK: 1 pedagog me titullin Prof. Dr., 1 me titullin Prof. Assoc. Dr., 18 me titullin Dr., 3 në proces për marrjen e titullit Dr., si dhe 11 me titullin M.Sc. Ndërsa për vitin akademik 2023-2024, përbërja e stafit ishte si vijon: • Stafi PAE: 3 pedagogë me titullin Prof. Dr., 5 me titullin Prof. Assoc. Dr., 7 me titullin Dr., dhe 2 me titullin M.Sc.; • Stafi PAK: 1 pedagog me titullin Prof. Dr., 1 me titullin Prof. Assoc. Dr., 13 me titullin Dr., 2 në proces për titullin Dr., dhe 13 me titullin M.Sc. Miratimi i strukturës mësimore për çdo vit akademik kryhet nga Dekanati i Fakultetit, në përputhje me procedurat institucionale. Ky proces zhvillohet mbi bazën e analizës së kërkesave të stafit akademik dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Sigurimi i cilësisë së programit është një komponent i pandarë i funksionimit akademik të Fakultetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen vlerësime të rregullta mbi ecurinë dhe përmbajtjen e programit, duke analizuar rezultatet akademike, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimet e studentëve. Në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Shkencave Politike, kjo njësi angazhohet për përmbushjen e objektivave të vlerësimit dhe hartimin e raporteve mbi cilësinë e programit. Gjithashtu, Njësia e Sigurimit të Cilësisë bashkëpunon rregullisht me strukturat homologe në Universitetin e Tiranës, duke përfshirë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, për të garantuar standardizimin dhe përputhjen me praktikat më të mira në fushën e arsimit të lartë. Falë këtyre mekanizmave, programi Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” synon të ofrojë një formim cilësor për studentët që kërkojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në fushat e administratës publike dhe politikave publike, duke mbetur një alternativë e vlefshme për formimin e specialistëve në këtë fushë.
--	--

	Fakulteti i Shkencave Sociale organizohet në pesë njësi bazë akademike: 1. Departamenti i Sociologjisë; 2. Departamenti i Shkencave Politike; 3. Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale; 4. Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë; 5. Departamenti i Filozofisë. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 2.5. Struktura organizative e FSHS 2024</i> <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.4 Te dhena tabelore per personelin akademik te programit</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi duke angazhuar personel të kualifikuar ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave mësimore. Ky angazhim siguron që procesi mësimor të jetë i mbështetur nga staf i trajnuar dhe i përgatitur mirë për të ofruar udhëzime të sakta dhe mbështetje për studentët gjatë aktiviteteve praktike. Personeli ndihmës është i përfshirë në organizimin dhe mbikëqyrjen e praktikave, duke garantuar që çdo aktivitet të zhvillohet sipas standardeve të kërkuara dhe në përputhje me rregulloret akademike dhe ligjore të institucioneve të arsimit të lartë. Kjo strukturë mbështet një përvojë mësimore cilësore dhe të plotë për studentët, duke i përgatitur ata për sfidat profesionale në këtë fushë. <i>Evidenca 3.17 Lista e marreveshjeve per praktiken profesionale</i> <i>Evidenca 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation</i> <i>Evidenca 4.1 Plan i mesimor i programit</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ecurisë dhe zhvillimin e programit, si dhe për realizimin e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit. Koordinatori i programit siguron që aktivitetet mësimore dhe praktikat profesionale të zhvillohen në përputhje me kërkesat akademike dhe profesionale, duke monitoruar përmbushjen e standardeve dhe duke mbajtur lidhje të ngushta me stafin akademik dhe administrativ. Ky rol është thelbësor për sigurimin e cilësisë dhe rritjen e efikasitetit të programit, si dhe për mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë procesit të studimit. <i>Evidenca 3.3 Rregullore e departamentit</i> <i>Evidenca 3.11 Vendim per caktimin e koordinatorit te programit</i> <i>Evidenca 3.12 Pershkrimi i detyrave te koordinatorit te programit</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi Master Profesional në “Qeverisja dhe

	<i>Politikat Publike” është një iniciativë e rëndësishme akademike, e mbështetur nga një strukturë e qartë organizative dhe një proces i mirëpërcaktuar i menaxhimit të cilësisë. Përmes angazhimit të Departamentit të Shkencave Politike, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ky program garanton një nivel të lartë akademik dhe profesionalizëm në përgatitjen e specialistëve në këtë fushë. Struktura e programit siguron që studentët të përfitojnë një formim të thelluar teorik dhe praktik, duke u mbështetur në përvojën e një trupe akademike të kualifikuar. Në të njëjtën kohë, vlerësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe përmirësimi i programit në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare siguron një mjedis akademik të qëndrueshëm dhe të besueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosjen e vetëvlerësimit si dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë “Qeverisje dhe Politika Publike” disponon informacionet e nevojshme mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi. Kjo njësi siguron transparencë dhe qartësi në të gjitha aspektet e programit, duke përfshirë objektivat, metodologjinë e mësimdhënies, ngarkesën me kredite, aktivitetet formuese, metodat e vlerësimit dhe mundësitë për zhvillim profesional. Informacionet janë të aksesueshme për studentët, stafin akademik dhe administrativ, duke ndihmuar në menaxhimin efektiv të programit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e arsimit të lartë. Kjo qasje siguron një organizim të qartë dhe efikas të procesit akademik, si dhe një përvojë mësimore cilësore për studentët. <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimeve Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Ky program është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 881, datë 12.08.2009 “Për hapjen e programeve të studimit master i nivelit të parë në Universitetin e Tiranës”, në përgjigje të kërkesave në rritje të shtetit dhe shoqërisë shqiptare për formimin e specialistëve dhe studiuesve të kualifikuar në fushën e shkencave politike, qeverisjes dhe politikave publike. Në fokusin e tij janë zhvillimi i aftësive për leadership politik,

	menaxhimin e administratës dhe administrimit publik, si dhe mbështetja e proceseve të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ky program ka një kohëzgjatje njëvjeçare dhe është i strukturuar në dy semestra akademike, duke i ofruar studentëve një ngarkesë prej 60 kreditesh ECTS. Struktura e tij është ndërtuar në mënyrë që të krijojë një ekuilibër të qëndrueshëm ndërmjet formimit teorik dhe angazhimeve praktike, duke kontribuar në përgatitjen e një profili të plotë profesional. Organizimi i qartë i planit mësimor, si dhe qasja e strukturuar ndaj ngarkesës akademike, siguron jo vetëm eficiencë në realizimin e programit, por edhe transparencë dhe akses të lehtësuar për studentët dhe stafin akademik. Në këtë mënyrë, krijohen kushtet e nevojshme për arritjen e objektivave akademike dhe profesionale, si dhe për ndërtimin e një baze të qëndrueshme për zhvillim të mëtejshëm në karrierë. <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ konstaton se rregullorja e Programit të studimit MP në “Qeverisja dhe Politikat Publike” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ky informacion është i qartë dhe i aksesueshëm për të siguruar që studentët të kuptojnë plotësisht kërkesat për t'u pranuar në program, mundësitë e transferimit të krediteve nga/tek institucione të tjera, si dhe procedurat për ekuivalentimin e studimeve të kryera jashtë institucioneve të arsimit të lartë. Kjo transparencë garanton një proces të drejtë dhe të standardizuar për studentët që duan të hyjnë në program ose të kalojnë nëpër faza të ndryshme të studimeve <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit te studimit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, përfshirë praktikën, seminarët, dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Këto syllabuse janë të detajuara dhe përmbajnë përshkrime të qarta të objektivave të lëndëve, aktiviteteve të mësimdhënies, materialeve të nevojshme dhe metodave të vlerësimit. Programi siguron që çdo komponent formues, përfshirë orët e punës praktike dhe seminarët, të realizohet në përputhje me formatet e miratuara dhe të standardizuar, duke mundësuar një mësimdhënie efikase dhe një përvojë mësimore të balancuar për studentët. <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i> <i>Evidenca 4.10 Format inovative te mesimdhënies</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në	Programi i studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” i nënshtrohet një procesi të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi, me qëllim rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së tij. Në fillim të çdo viti akademik, shqyrtohen dhe miratohen ndryshimet eventuale që konsiderohen të nevojshme, të cilat dokumentohen dhe arkivohen në mënyrë të plotë për




shqip dhe anglisht.	të siguruar transparencë dhe aksesueshmëri për studentët, stafin akademik dhe administrativ. Ky proces i rishikimit, kur përfshin deri në 20% të përmbajtjes së programit, bazohet në parashikimet e legjislacionit në fuqi, përkatësisht ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, si dhe Udhëzimit të MASR nr. 1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, duke ndjekur gjithashtu procedurën e përcaktuar në pikën 3.1.2.2 për “Ndryshime të vogla të programeve të studimit”. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 3.4 Urdhri per hapjen e programit te studimit</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit te studimit</i> <i>Evidenca 3.5 Strategjia e zhvillimit te programit te studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike” është i strukturuar në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e arsimit të lartë. Ai përmban një plan mësimor të qartë dhe të detajuar, duke siguruar një ndarje të mirëpërcaktuar të lëndëve në semestre, ngarkesën mësimore të moduleve dhe shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij. Programi, i organizuar në dy semestra me një total prej 60 kreditesh dhe kombinon në mënyrë të ekuilibruar njohuritë teorike me përvojën praktike, duke përfshirë leksione, seminare, praktika profesionale dhe studim individual. Gjithashtu, ky program përmban objektiva formues të qartë dhe të përshtatshëm për nivelin e studimeve të ciklit të dytë. Struktura e tij siguron një qasje të organizuar dhe efikase ndaj procesit akademik, duke garantuar një përvojë cilësore të të nxënit dhe zhvillim të mëtijshëm profesional. Për më tepër, transparencja dhe qasja e lehtë ndaj informacionit akademik dhe administrativ ndihmojnë në menaxhimin efektiv të programit dhe përmbushjen e objektivave të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në programin e studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme dhe/ose për punësimin e tyre. Çdo lëndë dhe aktivitet formues është i strukturuar për të siguruar që studentët të kenë njohuri të thelluara dhe të përgatiten për një karrierë profesionale. Struktura e programit ofron gjithashtu një përgatitje të thelluar dhe të mirëfilltë për studime të mëtejshme, duke krijuar një bazë të qëndrueshme dhe dinamike për studentët, e cila i mundëson atyre të avancojnë në ciklin e tretë të studimeve ose të integrohen me sukses në tregun e punës. <i>Evidenca 4.1 Plan i mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lëndëve</i>																														
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive në ECTS për programin e studimit është si më poshtë: <table><tr><th>Kategoria</th><th>Tipi</th><th>ECTS</th><th>%</th><th>Standardi</th></tr><tr><td>A</td><td>Lëndë Bazë</td><td>5</td><td>8.33%</td><td>5-10 %</td></tr><tr><td>B</td><td>Lëndë karakterizuese</td><td>24</td><td>40%</td><td>30-40 %</td></tr><tr><td>C</td><td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td><td>15</td><td>25%</td><td>20-30 %</td></tr><tr><td>D</td><td>Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale</td><td>6</td><td>10%</td><td>10%</td></tr><tr><td>E</td><td>Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar</td><td>10</td><td>16.67%</td><td>10-20 %</td></tr></table> Programi ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kategorive përkatëse me ngarkesën përkatëse në përputhje me VKM 41. Lëndët/modulet, shpërndarja e tyre në vite dhe semestre, si dhe vlerësimi në kredite dhe orët mësimore të programit “Qeverisja dhe Politika Publike”, janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe të sigurojnë rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Kjo shpërndarje e lëndëve siguron një progres të balancuar të njohurive dhe aftësive, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike të studentëve. Vlerësimi i krediteve dhe orëve mësimore është në përputhje me kërkesat e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), duke mundësuar një proces të qartë dhe të efektshëm të vlerësimit dhe përgatitjes shkencore, që mbështet zhvillimin e kërkimit dhe rritjen e	Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi	A	Lëndë Bazë	5	8.33%	5-10 %	B	Lëndë karakterizuese	24	40%	30-40 %	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	15	25%	20-30 %	D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	6	10%	10%	E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	10	16.67%	10-20 %
Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi																											
A	Lëndë Bazë	5	8.33%	5-10 %																											
B	Lëndë karakterizuese	24	40%	30-40 %																											
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	15	25%	20-30 %																											
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	6	10%	10%																											
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	10	16.67%	10-20 %																											

	cilësisë së studimeve. <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit të studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Politika Publike”, përfshirë përmbajtjen e lëndëve dhe raportin mes komponentëve teorikë dhe praktikë, është ndërtuar në përputhje të plotë me profilin e programit dhe është e përafërt me standardet e programeve homologe ndërkombëtare. Ky program synon të ofrojë një kombinim të qëndrueshëm mes njohurive të avancuara teorike dhe zhvillimit të aftësive praktike, me fokus të veçantë në formimin profesional të thelluar. Nëpërmjet këtij organizimi, studentët përgatiten për të ushtruar funksione të nivelit të lartë në administratën publike, organizata ndërkombëtare, institucione kërkimore apo sektorin privat, duke i pajisur me kompetenca për të analizuar dhe adresuar çështje komplekse të qeverisjes dhe politikave publike, si dhe për të kontribuar në mënyrë të qenësishme në proceset e vendimmarrjes dhe zhvillimit strategjik në fushat përkatëse. <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike” është konceptuar për të siguruar një balancë efektive midis formimit teorik dhe praktik, duke u strukturuar në funksion të arritjes së objektivave formues të programit dhe përgatitjes së studentëve për sfidat profesionale dhe akademike. Megjithatë, për shkak të kohëzgjatjes njëvjeçare, programi nuk përfshin mobilitetin e studentëve në kuadër të Erasmus+, stafi akademik ka përfituar nga marrëveshjet ndërkombëtare për trajnime dhe mësimdhënie, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Brenda dhe jashtë orëve mesimore, programi pasurohet me leksione të hapura të mbajtura nga figura të shquara të politikës shqiptare e ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, duke ofruar një dimension praktik dhe ndërveprues. Gjithashtu, programi përfshin praktikë institucionale, e cila zhvillohet në institucione publike, organizata joqeveritare apo kompani private, me qëllim përgatitjen konkrete të studentëve për tregun e punës dhe nxitjen e zhvillimit të tyre profesional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i> <i>Evidenca 4.10 Format inovative te mesimdhënies</i> <i>Evidenca 3.18 Raport vjetor te departamentit per vitin 2022-2023</i> <i>Evidenca 3.18.1 Raport vjetor te departamentit per vitin 2023-2024</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në	Syllabuset (programet e lëndëve/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që kompetencat e ofruara në programin e studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky përditësim i vazhdueshëm përfshin përzgjedhjen e

përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	literaturës bazë dhe ndihmëse të fundit, që reflekton zhvillimet më të reja. Ky proces siguron që studentët të jenë të përgatitur për kërkesat e tregut dhe të zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë më të reja, të cilat janë të kërkuara dhe të rëndësishme për suksesin e tyre profesional në të ardhmen. <i>Evidenca 3.2 Strategjia e zhvillimit të departamentit</i> <i>Evidenca 3.3 rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara nga studentët. Struktura e programit është e projektuar në mënyrë që të sigurojë një balancë të duhur mes teorisë dhe praktikës, duke mundësuar zhvillimin e njohurive të thelluara dhe aftësive praktike të nevojshme për të përballuar sfidat profesionale në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve. Aktivitetet formuese dhe veprimtaritë praktike, së bashku me metodologjitë e mësimdhënies, janë të orientuara për të siguruar që studentët të arrijnë rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe të zhvillojnë kompetencat e kërkuara për të pasur sukses në tregun e punës dhe studimet e mëtejshme. <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Programi i studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” është projektuar për të ofruar njohuri dhe aftësi që përputhen me kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës, duke mundësuar vijimin e studimeve në nivele të avancuara dhe/ose punësimit në sektorë të ndryshëm. Struktura fleksibël dhe përditësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes dhe metodologjisë siguron që studentët të pajisen me kompetencat e nevojshme për të përballuar sfida profesionale dhe për të ndërtuar karriera të suksesshme. Të diplomuarit nga ky program janë të përgatitur për të punuar në pozicione ekzekutive në administratën publike, në sektorin privat, në organizata jofitimprurëse, në parti politike, në media si analistë politike, si dhe në organizata ndërkombëtare. Një analizë e detajuar e tregut të punës, e mbështetur në një studim mbi vendosjen në punë të të diplomuarve në programet e Departamentit të Shkencave Politike, tregon se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë punësuar në mënyrë të barabartë në sektorin publik dhe privat, ku dominon sektori privat me 34% të të punësuarve, ndërsa punësimi në sektorin shtetëror dhe OJF raportohen përkatësisht me 11% dhe 9%. <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i> <i>Evidenca 3.10 Modeli i suplementit të diplomes</i>
Konkluzione	Në përfundim GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Politike, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe

	përmbajtjen e programit të studimit; Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit si dhe të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit zhvillohet në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke integruar vazhdimisht propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë të fushës. Ky proces konsultimi dhe feedbacku i rregullt siguron përditësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjen e tij me zhvillimet më të fundit në fushën e zgjidhjes së konflikteve dhe ndërmjetësimit, duke garantuar që studentët të fitojnë aftësi dhe njohuri të kërkuara nga punëdhënësit. Më konkretisht në Departamentin e Shkencave Politike, analiza dhe përmirësimi i programeve të studimit realizohet nëpërmjet raporteve vjetore të punës, vlerësimeve të cilësisë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe vetëvlerësimeve periodike. Për këtë qëllim, departamenti organizon takime të rregullta me personelin akademik dhe aktorë të ndryshëm të tregut të punës për të reflektuar mbi përmirësimin e përmbajtjes mësimore dhe përshtatjen me nevojat e tregut. Gjithashtu, bashkëpunimi me aktorët e tregut të punës, veçanërisht për praktikën mësimore, lehtëson integrimin profesional të studentëve dhe rrit mundësitë e tyre për punësim. <i>Evidenca 3.18 Raporti vjetor i Departamentit 2022-2023</i> <i>Evidenca 3.18.1 Raporti vjetor i Departamentit 2023-2024</i> <i>Evidenca 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation</i> <i>Evidenca 3.17 Lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte Periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve institucionale, GVJ konstatoi se njësia bazë angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në procesin e përfshirjes së studentëve dhe strukturave të tyre përmes anketimeve periodike dhe organizimit të konferencave shkencore të përbashkëta. Strategjia e konsultimit dhe ruajtjes së kontakteve me të

përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	diplomuarit shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për mbledhjen e kontributit të tyre profesional, duke mundësuar përshtatjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe objektivat akademike. <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Për të siguruar përditësimin dhe përshtatshmërinë e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve, GVJ rekomandon zgjerimin e konsultimeve me aktorë të ndryshëm dhe institucione relevante në vend. Këto bashkëpunime mundësojnë një kuptim më të thellë të nevojave profesionale dhe tregut të punës, duke u reflektuar në përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Një qasje e tillë garanton ruajtjen e cilësisë dhe relevancës akademike, duke i pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur standardet dhe praktikatat më të mira profesionale në fushën e tyre.			
Konkluzione	Në përfundim, GVJ konstaton se njësia bazë ka përfshirë në mënyrë aktive studentët dhe strukturat e tyre përmes anketimeve dhe organizimit të konferencave shkencore të përbashkëta, si dhe ka ndërtuar mekanizma efektivë të komunikimit me studentët e diplomuar. Megjithatë, GVJ rekomandon që Departamenti i Shkencave Politike të zgjerojë bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm në vend dhe të hartojë një strategji të strukturuar për konsultime të rregullta dhe të vazhdueshme me palët e interesuara, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kjo do të mundësojë identifikimin dhe përhithjen e nevojave reale të tregut të punës, duke u reflektuar më tej në përmirësimin e përmbajtjes akademike dhe tematikave të lëndëve të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit “Master Profesional në Qeverisja dhe Politikat Publike” përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të formimit akademik dhe kërkimit shkencor, duke i përshtatur ato me vizionin dhe objektivat strategjike të institucionit. Në këtë kuadër, programi synon zhvillimin e një baze të fortë teorike dhe praktike në fushën e qeverisjes dhe politikave publike, me fokus në përgatitjen e profesionistëve të aftë për të kontribuar në administratën publike, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat dhe shoqërinë civile. Aktivitetet mësimore dhe kërkimore janë të orientuara drejt çështjeve aktuale të menaxhimit publik, procesit

	të vendimmarrjes, reformave institucionale dhe zhvillimit të politikave të qëndrueshme. Gjithashtu, programi inkurajon angazhimin e studentëve në projekte kërkimore, praktika institucionale dhe analiza të rasteve konkrete, duke nxitur një qasje kritike dhe të ndërgjegjshme ndaj sfidave që lidhen me qeverisjen dhe politikat publike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo qasje e integruar siguron që objektivat e programit të jenë të lidhura ngushtë me nevojat e tregut të punës dhe me misionin e institucionit për të promovuar zhvillimin akademik dhe profesional cilësor. <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028</i> <i>Evidenca 4.5 Informacion per kerkimin shkencor ne nivel departamenti</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe takimeve me stafin akademik, GVJ konstaton se institucioni respekton dhe promovon lirinë akademike të personelit akademik, duke mbështetur zhvillimin e tyre shkencor dhe profesional. Departamenti i Shkencave Politike bashkërendon dhe administron në mënyrë efikase veprimtaritë akademike dhe kërkimore, duke garantuar një mjedis të hapur dhe të organizuar për kërkimin shkencor dhe mësimdhënien. Ky model menaxhimi siguron që personeli akademik të ketë mundësinë të zhvillojë dhe avancojë kërkimin në mënyrë të pavarur, ndërsa studentët të përfshihen në aktivitete që pasqyrojnë më së miri nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet shkencore të fushës. Për më tepër, realizimi i analizave mbi cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit, duke garantuar standarde të larta akademike dhe një përvojë studimore cilësore. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike” është ndërtuar për të nxitur dhe motivuar studentët në angazhimin aktiv në studime të thelluara, projekte praktike dhe aktivitete kërkimore, nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe elementeve interaktive si analiza rastesh, punë në grupe, praktika profesionale dhe leksione me ekspertë të fushës. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, Departamenti organizoi më 4 dhjetor 2023 konferencën studentore “Cultivating the Future Generation of Changemakers”, e cila përmbylli një cikël trajnimesh tematike me studentët e programit mbi çështje aktuale të politikave

	publike si anti-korrupsioni, reforma në administratën publike, integrimi në BE, siguria kibernetike, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe pastrimit të parave. Këto trajnime u shërbyen studentëve për të lidhur njohuritë teorike me praktikën e politikëbërjes dhe ndikimin e advokimit nga shoqëria civile, ndërsa si rezultat konkret i angazhimit të tyre u përgatitën dokumente politikash të cilat u prezantuan në konferencë. Ky proces kontribuon në zhvillimin e kompetencave analitike dhe profesionale të studentëve dhe përforcon misionin formues të programit. <i>Evidenca 4.10 Format inovative të mesimdhënis</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat e gjeneruara nga bashkëpunime apo aktivitete akademike, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës kërkimore, zhvillimin profesional të stafit dhe përfshirjen aktive të studentëve në projekte me karakter shkencor e aplikativ. Departamenti i Shkencave Politike promovon një klimë mbështetëse për zhvillimin e ideve inovative dhe nxit përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve në aktivitete shkencore, duke u ofruar mundësi për prezantime me kumtesa dhe publikime në revistën shkencore <i>Politikja</i>, e financuar plotësisht nga institucioni. Studentët ekselentë dhe ata në nevojë përfitojnë mbështetje përmes bursave apo reduktimeve tarifore, në kuadër të “Paktit për Universitetin”, ndërsa Këshilli Studentor i Universitetit të Tiranës përfiton fonde vjetore për organizimin e aktiviteteve dhe zbatimin e ideve inovatore. Për më tepër, këshillat studentore marrin pjesë në procesin vendimmarrës për çështje të rëndësishme akademike dhe financiare, duke përfshirë cilësinë e shërbimeve, tarifën, rregulloret, si dhe zhvillimin e veprimtarive kulturore, artistike e sportive. Gjithashtu, Departamenti ka organizuar aktivitete të shumta me mbështetjen e projekteve ndërkombëtare dhe financimeve nga organizatat e shoqërisë civile, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe dinamizmit akademik. <i>Evidenca 4.10 Format inovative të mesimdhënis</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit është plotësisht në përputhje me objektivat strategjike të institucionit dhe menaxhohet në mënyrë efektive nga njësia bazë, e cila garanton burimet e nevojshme për një funksionim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm. Nëpërmjet analizave periodike, njësia kryesore vlerëson cilësinë e procesit mësimor dhe kërkimor, duke siguruar përputhjen e programit me standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Njësia respekton dhe promovon lirinë akademike të pedagogëve, duke inkurajuar zhvillimin e tyre profesional dhe shkencor përmes mbështetjes financiare për projekte, publikime dhe kërkime shkencore. Për më tepër, duke eliminuar pengesat burokratike dhe duke ndjekur një procedurë transparente e të standardizuar, krijohet një mjedis akademik i hapur dhe frytdhënës. Kjo qasje jo vetëm që forcon kapacitetet kërkimore dhe akademike, por gjithashtu rrit cilësinë e mesimdhënis, duke e bërë programin një model të shkëlqyer të përputhjes midis</i>

	<i>formimit akademik dhe kërkesave të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse për programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore, duke siguruar bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë institucionit. Ky bashkëpunim forcon lidhjen mes teorisë dhe praktikës, duke orientuar aktivitetet kërkimore drejt objektivave të programit dhe kërkesave të tregut të punës. Pjesëmarrësit kanë mundësi të kontribuojnë në kërkime të avancuara në fushën e ndërmjetësimit, duke siguruar zhvillim të vazhdueshëm dhe përgatitje të mirë për profesionistët e ardhshëm. <i>Evidenca 3.17 Lista e marreveshjeve per praktiken profesionale</i> <i>Evidenca 3.18 Raport vjetor per vitin 2022-2023 i Departamentit</i> <i>Evidenca 3.18.1 Raport vjetor per vitin 2023-2024 i Departamentit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia përgjegjëse, në kuadër të angazhimit të saj për të përmbushur kërkesat që lidhen me analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor-shkencor, demonstroi një përkushtim të vazhdueshëm për të integruar mësimdhënien me kërkimin shkencor. Kjo realizohet përmes përfshirjes aktive të stafit akademik dhe studentëve në aktivitete kërkimore që synojnë zhvillimin profesional të stafit dhe avancimin e kompetencave akademike të studentëve. Departamenti i Shkencave Politike përfiton nga një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus+, si dhe nga pjesëmarrja në projekte të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve institucionale, si TESI, projekte kërkimore ndërkombëtare si COST, dhe iniciativa të mbështetura nga shoqëria civile. Në shumë prej këtyre nismave, studentët janë përfshirë drejtpërdrejt, duke u ofruar atyre mundësi konkrete për të qenë pjesë e proceseve të kërkimit dhe inovacionit në fushën e qeverisjes dhe politikave publike. <i>Evidenca 4.5 Informacion per kerkimin shkencor ne nivel departamenti</i> <i>Evidenca 3.18 Raport vjetor per vitin 2022-2023 i Departamentit</i> <i>Evidenca 3.18.1 Raport vjetor per vitin 2023-2024 i Departamentit</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë	Në kuadër të programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon në mënyrë të vazhdueshme konferenca, seminare dhe aktivitete të tjera akademike, të cilat synojnë të mbështesin arritjen e objektivave mësimore dhe kërkimore. Këto aktivitete shërbejnë si platformë për

personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	shkëmbimin e njohurive, nxitjen e debatit profesional dhe zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave akademike të personelit dhe studentëve, duke forcuar lidhjen midis teorisë dhe praktikës si dhe duke rritur cilësinë e formimit të tyre. <i>Evidenca 4.5 Informacion për kerkimin shkencor ne nivel departamenti</i> <i>Evidenca 4.10 Format inovative te mesimdhenies</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit synon formimin e profesionistëve të kualifikuar dhe konkurrues, të aftë për të përmbushur kërkesat e tregut të punës si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Ai ofron njohuri dhe aftësi të avancuara, të cilat i pajisin studentët me kompetencat e nevojshme për të kontribuar në mënyrë efektive në fushën përkatëse të studimit, duke u përshtatur me zhvillimet bashkëkohore dhe sfidat e mjedisit profesional global. <i>Evidenca 3.5 Strategjia e zhvillimit te programit te studimit</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Në kuadër të programit të studimit Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike”, njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton me seriozitet rekomandimet e nxjerra nga aktet ligjore të fushës, si dhe udhëzimet e institucioneve publike, organizatave profesionale dhe rrjeteve të ekspertëve që operojnë në fushën e administrimit publik, politikave publike dhe qeverisjes. Këto rekomandime shërbejnë si referencë për përcaktimin dhe përditësimin e kompetencave të nevojshme që studentët duhet të zotërojnë për t’u integruar në mënyrë të suksesshme në tregun e punës, veçanërisht në pozicione që lidhen me planifikimin, analizën dhe zbatimin e politikave publike. Shkencat Politike nuk janë një profesion i rregulluar.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N/A			
Konkluzione	Në përfundim, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse ofron mbështetje të qëndrueshme për grupet kërkimore-shkencore dhe ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi, duke financuar gjithashtu punën shkencore të stafit akademik. Ajo angazhon në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik dhe studentët në projekte të ndryshme, si konferenca shkencore dhe studime, duke siguruar një mjedis akademik të pasur dhe të zhvilluar për përparimin e kërkimit dhe përgatitjen e studentëve për sfidat e ardhshme profesionale. Ky angazhim i vazhdueshëm përmbush objektivat strategjike të programit dhe siguron që aktivitetet shkencore dhe mësimore të jenë të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet ndërkombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit “Qeverisja dhe Politikat publike” aplikon një shumëllojshmëri formash mësimdhënieje dhe mësimnxënijeje që mbështesin zhvillimin gjithëpërfshirës të studentëve dhe nxisin përvetësimin efektiv të njohurive dhe kompetencave të kërkuara në këtë fushë. Krahas leksioneve teorike dhe seminareve, programi përfshin edhe forma interaktive dhe praktike si detyra kursi, ese, projekte individuale dhe në grup, si dhe praktika profesionale, që i japin studentëve mundësinë të aplikojnë njohuritë në situata reale. Gjithashtu, orët e hapura dhe aktivitetet jashtë auditorit kontribuojnë në zhvillimin e mendimit kritik, të aftësive komunikuese dhe të angazhimit qytetar. Këto forma të diversifikuara janë në përputhje me objektivat e programit dhe sigurojnë një mjedis të favorshëm për të nxënit aktiv, bashkëpunues dhe të orientuar drejt rezultateve. Rëndësi i jepet gjithashtu përdorimit të metodave të miratuara institucionalisht, duke garantuar cilësi dhe koherencë në zbatimin e tyre. <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i> <i>Evidenca 4.10 Format inovative te mesimdhënies</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i përfshirë në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” demonstroi përkushtim ndaj një qasjeje gjithëpërfshirëse në mësimdhënie, duke respektuar diversitetin e studentëve dhe duke iu përgjigjur nevojave të tyre të ndryshme akademike dhe individuale. Në këtë kuadër, ofrohen forma dhe metoda alternative të mësimdhënies, të tilla si kombinimi i leksioneve ballë për ballë me platforma digjitale, përdorimi i materialeve ndihmëse shtesë, orët e konsultimit, si dhe adaptimi i mënyrës së komunikimit dhe vlerësimit sipas profilit të studentit. Kjo qasje e personalizuar synon të sigurojë përfshirje aktive,

	akses të barabartë dhe sukses akademik për të gjithë studentët, duke reflektuar një standard të lartë pedagogjik dhe ndjeshmëri institucionale ndaj larmisë në auditor. <i>Evidenca 4.1 Plan i mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i> <i>Evidenca 4.10 Format inovative të mesimdhënies</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e zhvillimit të departamentit</i> <i>Evidenca 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i> <i>Evidenca 3.17 Lista e marreveshjeve për praktiken profesionale</i> <i>Evidenca 4.8 Akses në bibliotekë</i> <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019</i> <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 4.10 Format inovative të mesimdhënies</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave të tyre didaktike, duke ofruar mundësi të rregullta për trajnime dhe zhvillim profesional në fushën e mësimdhënies. Kjo mbështetje është e orientuar drejt përputhjes së metodave dhe teknikave mësimore me rezultatet e pritshme të të nxënës, për të siguruar që studentët të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme në përputhje me kërkesat e programit. Institucioni organizon aktivitete të ndryshme si punëtori, seminare dhe trajnime, të cilat ndihmojnë personelin akademik të përditësojnë metodat mësimore dhe të përdorin teknologjitë më të reja në mësimdhënie. Kjo qasje e mbështetjes së stafit kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në realizimin e qëllimeve dhe kompetencave të përcaktuara për programin. <i>Evidenca 1.20. Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional</i> <i>Evidenca 3.18 Raport vjetor për vitin 2022-2023/2023-2024</i> <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 3.17 Lista e marreveshjeve për praktiken profesionale</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit “Qeverisja dhe Politikat Publike” është i kompetent dhe i aftë të shpjegojë njohuritë dhe konceptet në mënyrë të qartë dhe efektive, duke përdorur metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive. Këto metoda përfshijnë diskutime në grup, analiza rastesh, simulime dhe projektet që i japin mundësinë studentëve të angazhohen aktivisht dhe të zhvillojnë aftësitë analitike, mendimin krijues dhe kritik, si dhe të promovet autonomia dhe përgjegjshmëria e të nxënës. Kjo qasje nxit përfshirjen aktive të studentëve në procesin mësimor dhe siguron zhvillimin e kompetencave të nevojshme për të analizuar dhe aplikuar politikat publike në situata reale, duke i përgatitur ata për sfidat e

respektit të ndërsjellë mes tyre.	fushës. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e zhvillimit të departamentit</i> <i>Evidenca 4.11 CV e personelit akademik</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i> <i>Evidenca 1.24. Strategjia institucionale për mesimdhënien 2022-2027 vendim-nr.24</i> <i>Evidenca 3.18 Raport vjetor për vitin 2022-2023/2023-2024</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mesimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit “Qeverisja dhe Politikat Publike” vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mesimdhënies në mënyrë periodike, duke siguruar përfshirjen aktive të studentëve në këtë proces. Kjo është e mundur përmes sondazheve të rregullta të cilat mbledhin mendimet dhe sugjerimet e studentëve për përvojën e mesimdhënies. Ky proces reflekton angazhimin e institucionit për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mesimdhënies dhe për t’u përshtatur me nevojat e ndryshueshme të studentëve. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e metodave të mesimdhënies siguron që ato të jenë të orientuara drejt rezultateve konkrete të të nxëniet dhe që ato të jenë gjithmonë të përshtatshme për kërkesat e fushës dhe të tregut të punës. <i>Evidenca 3.18 Raport vjetor për vitin 2022-2023/2023-2024</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mesimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mesimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mesimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mesimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka krijuar struktura dhe njësi të dedikuara në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mesimdhënies. Këto struktura koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësitë kryesore të programit, duke siguruar një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar në zhvillimin e cilësisë së mesimdhënies. Struktura të tilla mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mesimdhënies, duke inkurajuar përdorimin e teknologjisë dhe qasjeve të reja pedagogjike që përmirësojnë angazhimin dhe përvetësimin e njohurive nga studentët. Njësitë përgjegjëse organizojnë trajnimet e rregullta për personelin akademik, duke i mundësuar atyre përmirësimin e aftësive didaktike dhe përvetësimin e metodave të reja të mesimdhënies, që ndihmojnë në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së procesit mësimor. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 3.11 Vendim për caktimin e koordinatorsit të programit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e zhvillimit të departamentit</i> <i>Evidenca 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni që ofron programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” ka krijuar një strukturë të qëndrueshme dhe të koordinuar për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të mesimdhënies dhe mesimnxënies. Duke u fokusuar në diversifikimin e

	metodave të mësimdhënies, si leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat profesionale dhe projektet, programi siguron një përvojë mësimore dinamike dhe interaktive për studentët. Personeli akademik është i mbështetur vazhdimisht përmes trajnimeve dhe mundësive për zhvillim profesional, që ndihmojnë në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe përputhjen me rezultatet e pritshme të të nxënësve. Për më tepër, njësitë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies sigurojnë mbështetje për eksperimentimin dhe implementimin e metodave inovative dhe përfshijnë studentët në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron një mjedis të mbështetur në cilësi dhe zhvillim të qëndrueshëm, që përgatit studentët për sfidat e fushës së qeverisjes dhe politikave publike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” janë të formalizuara dhe të dokumentuara në Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e Institucionit apo në rregullore të posaçme. Këto dokumente përcaktojnë qartë llojet e vlerësimeve që përdoren (provime, ese, projekte, prezantime, pjesëmarrje aktive, etj.), si dhe mënyrën e llogaritjes së notës përfundimtare. Të gjitha këto informacione u komunikohen studentëve që në fillim të vitit akademik apo të çdo lënde përmes syllabuseve dhe mjeteve të tjera informuese të institucionit. Publikimi dhe transparenca e këtyre kriterëve sigurojnë njohjen dhe mirëkuptimin e tyre nga studentët, duke garantuar objektivitetin, barazinë në vlerësim dhe ndërtimin e një klime akademike të drejtë e të parashikueshme. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mësimore të lendeve</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike”, transparenca dhe informimi i studentëve në lidhje me metodologjinë e vlerësimit është një praktikë standarde dhe e institucionalizuar. Në fillim të çdo lënde apo moduli, titullari i lëndës informon studentët mbi mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	shkencore, ashtu siç janë parashikuar në syllabusin përkatës. Kjo përfshin shpjegimin e peshës së çdo komponenti vlerësues (si provimet, detyrat me shkrim, pjesëmarrja aktive, projektet, etj.), afatet e dorëzimit dhe kriteret e vlerësimit. Një praktikë e tillë siguron orientim të qartë për studentët dhe i ndihmon ata të menaxhojnë më mirë procesin e të nxënies dhe përgatitjen akademike, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së procesit mësimor. <i>Evidenca 3.6 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike”, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet përmes formave dhe mënyrave të ndryshme, me qëllim që t’u jepet studentëve mundësia të demonstrojnë në mënyrë sa më të plotë dhe të drejtë kompetencat e fituara. Përveç provimeve tradicionale me shkrim ose me gojë, përdoren edhe ese, projekte kërkimore, prezantime, detyra analitike, punime në grup dhe diskutime të strukturuar, të cilat vlerësojnë si njohuritë teorike, ashtu edhe aftësitë praktike dhe analitike të studentëve. Ky diversifikim i metodave të vlerësimit ndihmon në evidentimin e stileve të ndryshme të të nxënies, rrit motivimin dhe përfshirjen e studentëve dhe siguron një vlerësim gjithëpërfshirës dhe objektiv të arritjeve të tyre akademike. <i>Evidenca 3.6 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi “Qeverisja dhe Politikat Publike” është i strukturuar në mënyrë të qartë, transparent dhe gjithëpërfshirës, duke respektuar parimet e barazisë, objektivitetit dhe cilësisë akademike. Kriteret dhe mënyrat e vlerësimit janë të përcaktuara në dokumentacionin rregullator të institucionit dhe të programit, bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të çdo lënde përmes syllabuseve përkatëse. Vlerësimi realizohet përmes një sërë metodash të kombinuara, që synojnë të masin jo vetëm përvetësimin e njohurive teorike, por edhe zhvillimin e aftësive praktike, kritike dhe analitike të studentëve. Përfshirja e formave të ndryshme të vlerësimit u jep studentëve mundësinë të shprehin potencialin e tyre në mënyra të ndryshme dhe ndihmon në ndërtimin e një përvojë mësimore cilësore dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete të të nxënies. Kjo qasje e integruar ndaj vlerësimit mbështet zhvillimin e kompetencave të nevojshme për sfidat e fushës së qeverisjes dhe politikave publike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike”, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik. Kjo qasje e shpërndarë e vlerësimit mundëson monitorimin e vazhdueshëm të progresit të studentëve dhe nxit përfshirjen e tyre aktive në procesin e të nxënit. Vlerësimi formativ dhe ai përmbledhës përfshihen në mënyrë të qartë në syllabusin e secilës lëndë, të hartuar dhe prezantuar nga titullari i saj. Kështu, nota përfundimtare përbëhet nga komponentë të ndryshëm vlerësimi si detyra të ndërmjetme, prezantime, pjesëmarrje aktive, projekte dhe provime përfundimtare duke reflektuar një pasqyrë të plotë dhe të balancuar të arritjeve të studentit gjatë gjithë periudhës mësimore. Kjo metodologji ndihmon në identifikimin e hershëm të vështirësive dhe në ofrimin e mbështetjes së duhur për përmirësimin e performancës akademike. <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mësimore të lëndëve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni ka implementuar sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit për të siguruar një proces të drejtë, të sigurt dhe transparent. Në bashkëpunim me AADF, Universiteti i Tiranës ka vendosur sistemin Clean Score, i cili mundëson korrigjimin e provimeve përmes teknologjisë informatike, duke u përshtatur me specifikat e fushave të studimit dhe kërkesat e pedagogëve. Po ashtu, për periudhën kur procesi mësimor është spostuar, në platformën e-learning Office 365, sistemi automatikisht gjeneron korrigjime për pyetjet e mbyllura. Përdorimi i këtyre sistemeve shmang mundësitë për abuzim dhe garanton mbrojtjen e integritetit të provimeve, duke përmirësuar transparencën dhe duke mundësuar monitorimin dhe kontrollin e detajuar të procesit të vlerësimit. Kjo qasje teknologjike kontribuon në një testim dhe vlerësim efikas, të besueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë studentët. <i>Evidenca 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” realizohet në përputhje me përmbajtjen e syllabusit dhe me legjislacionin në fuqi. Ky proces organizohet nga komisione provimesh, të përbëra nga jo më pak se dy pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës. Komisionet janë të emëruara nga departamenti dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit/zv. dekanët, në përputhje me rregulloren e fakultetit dhe të programit të studimit. Vlerësimi i

	përfundimtar i njohurive dhe aftësive të studentëve është i strukturuar dhe i standardizuar, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent, në përputhje me rregullat dhe kërkesat akademike dhe ligjore. Kjo qasje garanton integritetin e vlerësimit dhe respektimin e të drejtave të studentëve. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.1 Plan i mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” shoqërohet me komente dhe feedback konstruktiv nga ana e stafit akademik, veçanërisht në rastet kur ai është i nevojshëm për përmirësimin e performancës së studentit. Ky feedback jo vetëm që ndihmon studentin të kuptojë pikat e tij të forta dhe ato që kërkojnë përmirësim, por lidhet drejtpërdrejt me këshilla praktike mbi mënyrën e përmirësimit të të nxënës. Kjo praktikë kontribuon në zhvillimin e autonomisë, vetëvlerësimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë akademike tek studentët, si dhe mbështet një proces mësimor më efektiv, reflektiv dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete të të nxënës. Përmes këtij mekanizmi, vlerësimi shndërrohet në një mjet formues dhe zhvillues, jo vetëm për qëllime renditjeje. <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.1 Plan i mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në kuadër të sigurimit të integritetit akademik, njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” zbatojnë politika të qarta për të shmangur dhe parandaluar çdo formë të plagjiaturës apo kopjimit në provime dhe detyra. Këto standarde janë të formalizuara në dokumente rregullatore dhe njihen nga studentët që në fillim të studimeve. Përdoren mjete të posaçme për zbulimin e plagjiaturës, si programe softuerike dhe verifikime manuale nga pedagogët, ndërsa çdo shkelje trajtohet sipas procedurave disiplinore të institucionit. Kjo qasje ndihmon në krijimin e një kulture akademike të ndershmërisë, përgjegjshmërisë dhe respektit ndaj punës intelektuale, duke siguruar që vlerësimi të jetë i drejtë dhe meritë për të gjithë studentët. <i>Evidenca 1.5. kodi-i-etikes 2011</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore të lendeve</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike”, rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në parimin e meritës dhe objektivitetit. Procesi i vlerësimit respekton standardet akademike të përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit dhe programit të studimit, duke siguruar që çdo student të vlerësohet në mënyrë të

	drejtë dhe të paanshme. Për më tepër, rezultatet shpallen brenda afateve të përcaktuara në rregullore, duke garantuar transparencë dhe parashikueshmëri në raport me ecurinë akademike të studentëve. Kjo qasje meritokratike forcon besimin në sistemin e vlerësimit dhe ndihmon në motivimin e studentëve për të arritur rezultate të larta përmes përpjekjeve individuale. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni siguron mbrojtjen e të drejtave të studentëve në lidhje me procesin e vlerësimit, duke i mundësuar atyre qasje të plotë dhe transparente në rezultatet e vlerësimit. Studentëve u garantohej mundësitë për t'u njohur me detajet e vlerësimit dhe për të kërkuar rishikim të tij në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në statut dhe rregulloret përkatëse. Kjo qasje siguron një sistem të drejtë dhe të barabartë vlerësimi, duke krijuar mundësi për korrigjimin e çdo gabimi dhe për të siguruar se çdo student ka mundësinë të ketë një vlerësim të drejtë dhe objektiv. Kjo garanton integritetin e procesit akademik dhe i jep studentëve një mundësi për të shprehur shqetësimet e tyre në mënyrë të strukturuar dhe ligjore. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë ose ankim lidhur me vlerësimin e studentëve shqyrtohet në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe kalon në një proces të dyfishtë verifikimi. Ankesa mund të paraqitet me shkrim tek përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i departamentit realizon verifikimet e nevojshme dhe, nëse vlerëson se zgjidhja e ankesës është e pamundur, e njofton menjëherë dekanin/drejtorin. Dekani/drejtori, brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit për ankesën, ngre një komision ad-hoc për të shqyrtuar dhe verifikuar pretendimet e studentit. Komisioni, pas shqyrtimit të detajuar, dhe me miratimin e dekanit/drejtorit, përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Ky proces siguron një shqyrtim të plotë, të paanshëm dhe transparent të çdo ankese, duke garantuar që çdo vendim të merret në përputhje me rregullat dhe standardet akademike. Procedura e ndjekur është e detajuar dhe transparente për të gjitha palët e përfshira, duke siguruar që çdo hap i procesit të dokumentohet dhe arkivohet, për të garantuar që çdo vendim të jetë i bazuar në fakte dhe të respektojë të drejtat e studentëve. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i>

Konkluzione	GVJ vlerëson se procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin “Qeverisja dhe Politikat Publike” është i strukturuar dhe i standardizuar për të siguruar transparencë, objektivitet dhe barazi për të gjithë studentët. Kriteret dhe metodat e vlerësimit janë të qarta dhe publike që në fillim të çdo lënde, duke përfshirë mundësinë për të kërkuar rishikim të rezultateve. Përdorimi i formave të ndryshme të vlerësimit, të tilla si provime, ese, projekte, prezantime dhe detyra, mundëson një pasqyrë të gjerë dhe të detajuar të arritjeve të studentëve. Kjo qasje multidimensionale siguron një vlerësim të drejtë dhe të balancuar, që i jep mundësi studentëve të shprehin potencialin e tyre në mënyra të ndryshme. Për më tepër, mbështetja për mbrojtjen e integritetit akademik dhe përdorimi i teknologjisë për testimin dhe vlerësimin rrisin besueshmërinë dhe ndihmojnë në eliminimin e praktikave të padrejta. Procesi i shqyrtimit të ankesave siguron një mundësi për zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë të çdo çështjeje që mund të lindë. Kjo strukturë e qartë dhe e mirëorganizuar rrit cilësinë e mësimdhënies dhe siguron përparimin e studentëve në mënyrë të drejtë dhe profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike” është strukturuar në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive teorike dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve, në përputhje me kërkesat e ciklit të dytë të studimeve. Plani mësimor përfshin 10 lëndë, përfshirë praktikën profesionale dhe punimin përmbyllës (formimin/diplomën), të cilat shërbejnë si platformë për integrimin dhe aplikimin e njohurive të marra gjatë studimeve. Gjithashtu, ofrohen dy lëndë me zgjedhje nga një paketë prej 10 lëndësh, duke u dhënë studentëve fleksibilitet për t'u specializuar në fusha me interes. Harmonia ndërmjet lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe atyre plotësuese siguron një formim të plotë, të balancuar dhe të orientuar drejt nevojave të tregut të punës dhe sfidave aktuale të qeverisjes dhe politikëbërjes. <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha mbështetëse si teknologjia e informacionit, komunikimi, ndërveprimi social të cilat janë thelbësore për përgatitjen e një profesionisti bashkëkohor në fushën e qeverisjes dhe politikave publike. Përmes integritit të lëndëve specifike dhe përdorimit të metodave

	bashkëkohore të mësimdhënies, studentët përvetësojnë aftësi për të përdorur në mënyrë efektive mjetet digjitale për analizën e politikave, hartimin e dokumenteve administrative dhe prezantimin profesional të ideve. Gjithashtu, aftësitë sociale dhe humane zhvillohen nëpërmjet angazhimit në diskutime, punë në grup dhe simulime të proceseve vendimmarrëse, çka kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit etik dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor. <i>Evidenca 4.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që studenti fiton gjatë procesit mësimor janë të qarta dhe të strukturuar në programin e studimit dhe syllabuset përkatëse të çdo lënde. Në përfundim të secilës lënde, këto kompetenca analizohen dhe shqyrtohen nga personeli akademik për të vlerësuar nivelin e përvetësimit dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë. Përmes diskutimeve, konsultimeve individuale dhe feedback-ut të vazhdueshëm, pedagogët eidentojnë çështjet më të rëndësishme për zhvillimin profesional të studentëve dhe i orientojnë ata drejt mënyrës së aplikimit të njohurive të fituara. Gjithashtu, jepet udhëzim i qartë për realizimin e detyrimeve përmbyllëse të lëndës, duke nxitur refleksionin dhe integrimin e njohurive në funksion të kompetencave të synuara nga programi. Kjo qasje e strukturuar garanton një proces mësimor efektiv dhe të orientuar drejt rezultateve të matshme të të nxënit. <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i studimit realizon mësimdhënie mbi bazë kompetencash, duke ofruar mundësi për studentët që të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra, jo vetëm në kontekst teorik, por edhe në praktika profesionale. Personeli akademik luan një rol kyç në mbështetje të diskutimeve dhe punës në grup, duke orientuar studentët për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. Kjo qasje promovon një mjedis të pasur për zhvillimin e ideve inovative dhe inkurajon studentët të kontribuojnë në studime të përparuara kërkimore e shkencore, duke i mbështetur ata në procesin e kërkimit dhe zgjidhjes së sfidave praktike. Po ashtu, programi ndërthur format e mësimdhënies me institucione bashkëpunuese, duke mundësuar mobilitetin e studentëve dhe mundësi për përvojë ndërkombëtare. Ky integrim i praktikës, kërkimit dhe bashkëpunimit me institucione të tjera rrit cilësinë e përgatitjes profesionale dhe shkencore të studentëve, duke i mundësuar atyre një përvojë më të pasur dhe të gjithanshme. <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 3.5 Strategjia e zhvillimit te programit te studimit</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mesimore te lendeve</i>

	<i>Evidenca 3.17 Lista e marreveshjeve per praktiken profesionale</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në programin Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike”, personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare si brenda ashtu edhe jashtë strukturës së programit të studimit. Këto aktivitete ofrojnë mundësi për studentët që të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me avancimet më të fundit të praktikave profesionale, duke i ndihmuar ata të qëndrojnë të përditësuar dhe të përgatitur për sfidat e ndryshimeve të fushës. Seminaret dhe orët e hapura gjithashtu krijojnë mundësi për diskutime dhe shkëmbim idesh, duke inkurajuar studentët të zhvillojnë mendimin kritik dhe të përvetësojnë njohuri të avancuara që mund të jenë të dobishme në karrierën e tyre profesionale. Ky angazhim i personelit akademik për të mbajtur studentët të informuar mbi zhvillimet më të fundit kontribuon në cilësinë dhe relevancën e programit të studimit. <i>Evidenca 4.10 Format inovative te mesimdhenies</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni tregon angazhim të qëndrueshëm në mbështetjen e studentëve përmes politikave të mbështetjes financiare dhe nxitjes së ideve inovative. Studentët ekselentë dhe ata nga shtresat në nevojë përfitojnë nga bursa ose reduktime tarifash në kuadër të “Paktit për Universitetin”, ndërsa Këshilli Studentor mbështetet çdo vit me një fond të dedikuar për aktivitete dhe projekte studentore. Këshillat studentore përfshihen aktivisht në proceset vendimmarrëse, duke kontribuar me mendime dhe propozime për çështje që lidhen me cilësinë e arsimit, tarifat, planet mësimore dhe jetën studentore. Departamenti i Shkencave Politike krijon një ambient që nxit kërkimin dhe inovacionin përmes bashkëpunimit me studentët në projekte, konferenca dhe trajnime tematike, në bashkëpunim me organizata si IDM. Studentëve u jepet mundësia të publikojnë punimet e tyre në revistën shkencore “Politikja” dhe të prezantojnë kontributet e tyre në aktivitete shkencore me pjesëmarrje të gjerë akademike dhe shoqërore. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit te Tiranës-2022</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit ndihmon në zhvillimin e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve, por gjithashtu i pajis ata me njohuritë dhe praktikën më të mira në fushën përkatëse. Përmes një qasjeje të balancuar midis teorisë dhe praktikës, studentët aftësohen të analizojnë dhe të zgjidhin në mënyrë kritike problematikat e ndryshme profesionale. Për më tepër, përfshirja në projekte kërkimore dhe aktivitete praktike rrit ndjeshëm kapacitetin e tyre për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm në karrierën e tyre të ardhshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni zbaton një procedurë të strukturuar dhe të posaçme për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, e cila hartohet paraprakisht dhe bëhet e njohur për studentët në kohë të duhur. Kjo procedurë përfshin udhëzime të qarta mbi format, afatet dhe mënyrën e dorëzimit apo mbrojtjes së punimeve përfundimtare, duke siguruar transparencë, barazi dhe cilësi në vlerësimin përfundimtar të studentëve. Publikimi i këtyre rregullave garanton një proces të parashikueshëm dhe të drejtë, duke i mundësuar studentëve të organizohen në mënyrë efikase dhe të përmbushin me sukses detyrimet e tyre akademike. <i>Evidenca 1.9. Rregullore-për-diplomimin UT</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Institucioni zbaton një procedurë të qartë dhe transparente për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, si mbrojtja e punimit të diplomës apo dhënia e provimit përfundimtar, të cilat janë kushte për marrjen e diplomës. Studentët informohen paraprakisht mbi natyrën e detyrimit që do të përmbushin, temat e provimit përfundimtar dhe kërkesat akademike për hartimin dhe prezantimin e punimeve. Provimi përfundimtar realizohet përpara një komisioni të përbërë nga të paktën tre anëtarë, duke siguruar objektivitet dhe vlerësim të drejtë. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ofrojnë mbështetje të vazhdueshme, duke vënë në dispozicion udhëzime të detajuara, materiale ndihmëse dhe asistencë për të garantuar që studentët të përmbushin me sukses dhe cilësi standardet akademike të detyrimeve përmbyllëse. <i>Evidenca 1.9. Rregullore-për-diplomimin UT</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Departamenti i Shkencave Politike ndërmerr një proces të strukturuar për organizimin e provimit të formimit në ciklin Master Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike”, duke hartuar një program të detajuar që reflekton përfaqësueshmërinë e lëndëve të zhvilluara gjatë vitit akademik dhe duke e përcjellë për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore. Komisioni për hartimin e tezës së provimit siguron gjithëpërfshirjen e përmbytjes përmes pyetjeve të hartuara mbi bazën e programit të shpërndarë më parë te studentët, duke garantuar një vlerësim të drejtë dhe të barabartë. Personeli akademik angazhohet aktivisht në mbështetjen e studentëve përmes konsultimeve të vazhdueshme dhe orareve të posaçme për orientimin drejt provimit final. Komisioni për administrimin e provimit përfundimtar vepron mbi bazën e një procedure të qartë, duke vlerësuar njohuritë e akumuluar gjatë gjithë ciklit të studimeve në përputhje me peshën specifike të lëndëve dhe objektivat e programit, në funksion të

	sigurimit të cilësisë akademike dhe formimit profesional të studentëve. <i>Evidenca 3.6 Rrregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik, dhe në veçanti udhëheqësi i diplomës, ofron orientim dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i diplomës ndihmon studentët në procesin e zgjedhjes së një teme të përshtatshme dhe relevante për fushën e studimit, duke siguruar që tema të jetë e qartë, e realizueshme dhe të kontribuoni në zhvillimin e njohurive shkencore dhe profesionale. Po ashtu, udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen dhe përpunimin e rezultateve kërkimore, si dhe në shkrimin e punimit përmbyllës në përputhje me udhëzuesit dhe standardet akademike të miratuara. Ai garanton cilësinë e punimit të diplomës duke inspektuar përmbajtjen dhe metodologjinë, dhe, përpara paraqitjes së punimit për komisionin, udhëheqësi miraton ose jo përfundimin e tij, duke siguruar që punimi është i plotë dhe i përshtatshëm për shqyrtim. Ky proces mbështet një nivel të lartë të cilësisë dhe e siguron që studentët të përfundojnë punimin e diplomës në përputhje me standardet akademike. <i>Evidenca 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët në realizimin e hulumtimeve brenda kuadrit të lëndëve të programit, duke u siguruar atyre akses në burime dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e punës kërkimore dhe praktike. Fakulteti i Shkencave Sociale disponon një bibliotekë fizike me një fond prej 7343 titujsh, ndërkohë që një rëndësi e veçantë i është kushtuar gjithashtu përdorimit të bibliotekave online, të cilat ofrojnë akses të pakufizuar në kohë. Ky kombinim burimesh tradicionale dhe digjitale u mundëson studentëve dhe pedagogëve konsultimin me një gamë të gjerë studimesh prestigjioze në nivel global në fushën e shkencave politike, duke përmirësuar cilësinë e kërkimit shkencor, detyrimeve përmbyllëse dhe procesit të mësimdhënies në tërësi. <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 4.8 Aksesi në bibliotekë</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti i nënshtrohet një procesi vlerësimi nga komisioni përkatës dhe përfundon me marrjen e një note përfundimtare. Ky vlerësim reflekton nivelin e njohurive, aftësive analitike dhe profesionale të treguara nga studenti gjatë procesit të mbrojtjes apo provimit, në përputhje me standardet akademike dhe objektivat e programit të studimit. <i>Evidenca 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS</i> <i>Evidenca 3.6 Rrregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të cilat janë miratuar nga ministria

diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	përgjegjëse për arsimin, duke garantuar njohjen zyrtare të arritjeve të tij akademike. Po ashtu, studentit i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e plotë e programit të studimit të zhvilluar, e cila dokumenton përmbajtjen dhe strukturën e programit, duke ofruar transparencë të plotë mbi kurikulat dhe kualifikimet e fituara gjatë periudhës së studimeve. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS</i> <i>Evidenca 3.10 Modeli i suplementit të diplomes</i> <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan dhe administron dokumentacionin e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar ruajtjen e sigurt dhe konformitetin me normat ligjore dhe të privatesisë. Ky dokumentacion përfshin të dhëna të rëndësishme mbi përparimin akademik, provimet, diplomimin dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për proceset administrative. Në raste specifike, institucioni mund të ofrojë informacion mbi studentët, duke garantuar transparencë dhe respektimin e të drejtave të tyre. Dokumentacioni bazë për çdo student përfshin: ➤ Regjistrin themeltar të studentit, i cili dëshmon regjistrimin dhe pajisjen me numër matriculimi deri në përfundimin e studimeve dhe marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse. ➤ Regjistrin e arritjeve akademike, që pasqyron rezultatet dhe ecurinë akademike të studentit gjatë gjithë periudhës së studimeve. ➤ Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, i cili dokumenton dhënien e diplomave dhe certifikatave, duke garantuar saktësinë dhe integritetin e të dhënave. Kjo strukturë e dokumentimit siguron një menaxhim të rregullt dhe të besueshëm të informacionit akademik, duke mbrojtur të drejtat e studentëve dhe duke mundësuar një administrim efikas të të dhënave institucionale. <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni demonstroi një angazhim të fortë për mbështetje të studentëve gjatë gjithë procesit të studimeve, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, përfshirë asistencën për hulumtime dhe aksesin në burime të rëndësishme akademike, si biblioteka fizike dhe online. Komisionet për</i>

	administrimin e provimeve janë të strukturuar dhe sigurojnë një vlerësim të drejtë dhe të plotë të njohurive të studentëve, duke iu dhënë mundësinë për t'u vlerësuar në përputhje me standardet e kërkuara. Po ashtu, procedurat për pajisjen me diplomë dhe dokumentacionin përkatës janë të qarta dhe përputhen me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke siguruar transparencë dhe mbrojtje të të dhënave personale të studentëve. Ky angazhim për cilësinë dhe mbështetje të studentëve kontribuon në zhvillimin e një ambienti akademik që promovon njohuri të thelluara dhe aftësi profesionale të larta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Njësitë përgjegjëse të institucioneve akademike sigurojnë mjedise të përshtatshme për praktikën laboratorike dhe profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë institucionit, për të mbështetur zhvillimin e aftësive praktike dhe përfitimin e njohurive të avancuara nga studentët. Këto mjedise janë të pajisura me burime dhe infrastrukturë të nevojshme për realizimin e aktiviteteve kërkimore dhe praktike, duke mundësuar që studentët të zbatojnë teorinë në praktikë dhe të angazhohen në mjedise reale pune. Programi i studimit është hartuar në përputhje me VKM 41 dhe parashikon zhvillimin e një praktike institucionale prej 125 orësh (6 kredite), që përbëjnë 10% të ngarkesës totale, pranë institucioneve partnere, duke kontribuar në forcimin e lidhjeve mes mësimdhënies dhe praktikës, si dhe në përmirësimin e cilësisë së formimit akademik dhe profesional të studentëve. <i>Evidenca 3.17 Lista e marreveshjeve për praktiken profesionale</i> <i>Evidenca 4.1 Plani mesimor i programit</i> <i>Evidenca 4.3 Paketa e praktikës për programin e studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet me organizata të tjera, garanton realizimin e praktikave profesionale duke i dhënë mundësi studentëve të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve në mjedise praktike të avancuara dhe të lidhura ngushtë me zhvillimet e fundit në fushën e tyre profesionale. Praktikantët janë të organizuar në mënyrë që studentët të përfitojnë sa më shumë nga eksperiencat e drejtpërdrejta në terren, dhe për të zhvilluar kompetenca të larta profesionale. Kjo strategji ofron një mundësi për studentët që të përgatiten për sfidat e ardhshme profesionale dhe të rrisin aftësitë e

	tyre praktike përmes trajnimeve dhe eksperiencës të udhëhequr nga ekspertë të fushës. <i>Evidenca 3.17 Lista e marreveshjeve per praktiken profesionale</i>			
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktikant profesionale gjatë programit të studimeve janë të ekuivaluara në kredite dhe dokumentohen në mënyrë të strukturuar, duke u shoqëruar me vlerësime nga mentorët. Ky proces siguron një pasqyrë të qartë dhe të drejtë të përvojës praktike, duke reflektuar ndikimin e saj në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Dokumentimi i këtyre praktikave siguron një pasqyrë të plotë dhe verifikueshme të përvojës profesionale, e cila është thelbësore për zhvillimin e aftësive të studentëve dhe për arritjet e tyre akademike. <i>Evidenca 4.3 Paketa e praktikës per programin e studimit</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se praktikant profesionale të programit Master Profesional “Qeverisja dhe Politikant Publike” sigurojnë një përvojë të balancuar dhe të strukturuar që mundëson zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Ekuivalenca e këtyre aktiviteteve me kredite dhe vlerësimi i qartë dhe objektiv nga trajnerët dhe mentorët, i ofron studentëve një pasqyrë të verifikueshme dhe të plotë të përvojës praktike, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në përfundimin e studimeve. Kjo qasje garanton një proces të drejtë dhe të vazhdueshëm vlerësimi, duke mbështetur cilësinë e praktikave profesionale dhe duke kontribuar në përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale në fushën e zgjidhjes së konflikteve me ndërmjetësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në	Referuar vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ vlerëson se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master

realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Profesional në “Qeverisje dhe Politika dhe Publike” i përshtaten kërkesave të këtij programi studimi, kjo në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.5.2017, ku saktësohet se njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik (PAE dhe PAK), sikurse dhe personelin administrativ. Në këtë program studimi janë angazhuar lektorë me tituj dhe grada shkencore sipas kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, (UT), janë parashikuar të gjitha modalitetet që sigurojnë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe fushën kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Ky vlerësim bazohet në shqyrtimin e dosjeve të personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në takimin e drejtpërdrejtë me stafin akademik dhe atë ndihmës, ku titullarët e lëndëve janë me të paktën gradën shkencore Dr. ose të kategorisë profesor. Fusha akademike e lektorëve të angazhuar në programin Master Profesional “Qeverisje dhe Politika Publike”, është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një eksperiencë disavjeçare edhe në fushën kërkimore.

Kjo vërtetohet edhe nga shqyrtimi që GVJ u bëri dosjeve të personelit akademik, CV akademike të tyre, të cilët kanë kontribute shkencore në fushat që mbulojnë, si punime doktorature, trajnime afatgjata dhe afatshkurtra, mësimdhënie në fusha të njëjta, përafërta apo të ngashme. Për të gjithë lektorët e mësimdhënësit, gjykojmë se është respektuar fusha e ekspertizës.

Personeli efektiv dhe kontratë i angazhuar në programin e studimit Master Profesional “Qeverisje dhe Politika Publike”, është organizuar si më poshtë:

Titulli/Grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr.	1	0	1	0
Prof. as. dr.	0	0	1	0
Dr/PhD	5	6	4	4
Dr në proces	0	0	0	0
MsC	0	2	0	2
TOTALI	6	8	6	6

	Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master Profesional, janë të angazhuar staf akademik sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT;</i> <i>Evidenca 4.11. CV e personelit akademik;</i> <i>Evidenca 4.13 Anekset e RVB-së me të dhënat përmbledhëse të stafit akademik, Tabela 6,7;</i> <i>Evidenca 4.4 Te dhena tabelore per personelin akademik te programit.pdf</i>									
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga të dhënat që ka paraqitur Departamenti i Shkencave Politike për planifikimin e ngarkesës mësimore për çdo vit akademik dhe realizimin e saj për programin e studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike", rezulton se për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 për të cilat disponojmë dokumentacionin përkatës, nuk është respektuar raporti i mësimdhënies midis PAE/PAK (i cili duhet të jetë në masën 70% për PAE dhe 30% për PAK) sipas përcatimit ligjor në fuqi. Mbulimi i ngarkesës mësimore për programin e studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike", nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë nga të dhënat e pasqyruara në tabelat përmbledhëse, rezulton si më poshtë: <table><tr><th>Viti Akademik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>56.3%</td><td>43.6%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>52.5%</td><td>47.5%</td></tr></table> Duke qenë se përqindja e mbulimit të ngarkesës mësimore nga PAE është shumë më poshtë normës së lejuar sipas përcaktimeve ligjore, ndërkohë që mbulimi nga PAK është mbi normën 30% të lejuar, GVJ rekomandon që institucioni të përmbushë përcaktimet ligjore për mbulimin e ngarkesës mësimore nga PAE në masën 70% të saj dhe mbulimin e ngarkesës mësimore në masën 30% nga PAK, duke sjellë kështu përmirësimin e efektivitetit të procesit mësimor. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 4.4 Te dhena tabelore per personelin akademik te programit te studimit, Ngarkesa totale e personelit akademik (Tabela 4, 7,13)</i>	Viti Akademik	PAE	PAK	2022-2023	56.3%	43.6%	2023-2024	52.5%	47.5%
Viti Akademik	PAE	PAK								
2022-2023	56.3%	43.6%								
2023-2024	52.5%	47.5%								
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit	GVJ konstaton se UT ka një përvojë të konsiderueshme dhe burimet e duhura në fushën akademike në përputhje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen e dijës tek studentët. UT, FShS dhe DShP,									

akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	dëshmojnë se kanë kapacitetet e duhura në fushën akademike, mësimdhënëse për ofrimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike". Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohej nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë programi studimi, personel i cili ka kontrata paafat dhe është i punësuar pranë IAL prej shumë vitesh, e cila u konfirmua edhe nga vizita në institucion në diskutim me stafin akademik të angazhuar në mësimdhënien, në këtë program studimi. Procedura për rekrutimin e personelit akademik, realizohet sipas procedurës së parashikuar në nenin 64 e në vijim, të Statutit të UT-së dhe Manualin mbi punësimin e personelit të Universitetit të Tiranës dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, mbledhen dhe përditësohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik (PAE dhe PAK), sikurse dhe personelin administrativ. Zyra përgjegjëse ruan kopjet e dokumentacionit, ndërsa dokumentet origjinale ose të noterizuara mbledhen në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (njësi në nivel universiteti) <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e FShS</i> <i>Evidenca 4.4. Të dhënat tabelore të stafit akademik Tabela 7</i> <i>Evidenca 4.11 CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	UT rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren dhe Statutin e UT-së. Manuali për punësimin e personelit të UT, sipas kategorive të ndryshme, ka shërbyer për standardizimin e praktikës dhe procedurës së rekrutimit dhe vlerësimit, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura. Manuali përcakton fazat e veprimit dhe krijon kornizën ligjore për punësimet, duke e bërë këtë proces më transparent dhe të bazuar më shumë në meritën dhe aftësinë e kandidatëve konkurrues. Përzgjedhja e personelit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi, është bërë sipas nevojave të Njesisë Bazë (Departamentit), i cili ka përcaktuar paraprakisht me vendim të veçantë kriteret specifike mbi kategoritë e personelit akademik që kërkon të punësojë për vendet vakante. Shpallja e vendit/eve vakante për personelin akademik, bëhet në ëb faqet zyrtare. Përgjegjësi i njesisë

	kryesore, ngre një komision ad hoc për përgjedhjen e kandidatëve, të përbërë nga 5 anëtarë të kategorisë Prof.as.dr, të cilët nuk duhet të kenë konflikt interesi. Referuar nenit 68 të Statutit të UT, për personelin me kohë të pjesshme, njësitë kryesore, me propozim të njërive bazë që kanë përcaktuar nevojat e tyre për personel jo efektiv, i kërkojnë Rektorit miratimin e kontratave të përkohshme për këtë kategori. GJV konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e UT;</i> <i>Evidenca 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT;</i> <i>Evidenca 4.11. CV e personelit akademik;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	UT, siguron punësimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike dhe të mjediseve të tjera mësimore referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij. Numri i personelit ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi, është 1 (një) laborant.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GJV referuar takimeve në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, konstaton se institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, përmes Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arshivës në njësinë kryesore. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet me një dosje personale fizike, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Degën e Burimeve Njerëzore. GJV kontrollon në mënyrë rastësore dosjet të personelit akademik efektiv dhe me kontratë dhe evidentoi se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit. Për personel akademike me kontratë, pjesë e dosjes së personelit është dhe vlerësimi, me qëllim rinovimin ose jo të kontratës. <i>Evidenca 2.5. Struktura organizative e FShS 2024;</i> <i>Evidenca 2.18. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit akademik;</i> <i>Evidenca 2.21. Udhëzim për dosjen e pedagogut;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,	Të dhënat e paraqitura në RVB për këtë program studimi dhe gjatë vizitës në institucion, tregojnë se FSHS, DSHP, ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, bashki, biznese dhe organizata të shoqërisë civile për praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike të studentëve në funksion të realizimit të programit të studimit Master Profesional "Qeverisja dhe

udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Politikat Publike". Kapacitetet e FShS dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera, mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike në përmbushje të praktikës profesionale dhe në funksion të punimit të temës së diplomës. Në kuadër të procesit të kryerjes së praktikës profesionale, FShS dhe DShP janë angazhuar në realizimin e marrëveshjeve me organizata të ndryshme në nivel vendor apo qendror. Këto marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale, mundësohen me qëllim aftësimin praktik të studentëve në profilin e programit të studimit. Studentët gjithashtu janë përfshirë në projekte të ndryshme, nëpërmjet bashkëpunimit me shoqatat respektive. Referuar edhe Manualit udhëzues për praktikën profesionale, praktika, ka si qëllim krijimin e shprehive profesionale praktike tek studentët, nëpërmjet njohjes së drejtëpërdrejtë të punës në institucione të ndryshme që kanë si pjesë të tyre organizimin, funksionet qeverisëse dhe politikat publike. <i>Evidenca 3.17. Lista e marreveshjeve pwr praktikwn profesionale;</i> <i>Evidenca 3.19. Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit;</i> <i>Evidenca 4.3. Paketa e praktikës profesionale;</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ gjatë shqyrtimit të DVV-së dhe takimeve me personelin akademik dhe studentë të këtij programi studimi, konstaton se referuar përmbushjes së detyrimeve sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit për të zhvilluar praktikat profesionale, institucionet pritëse angazhohen në mënyrë specifike për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve ku një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësimin të studentëve për të realizuar jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik të tyre. Në përfundim të periudhës së praktikës, referuar paketës për praktikën profesionale, studentët dorëzojnë raportin e përgatitur nga personi mbikqyrës i institucionit ku ka kryer praktikën, sipas formatit standard të hartuar nga njësia bazë (Departamenti) si dhe raportin e përgatitur nga studenti sipas formatit të hartuar nga Departamenti i Shkencave Politike. <i>Evidencë 3.6 Rregullore e programit të studimit Master Profesional "Qeverisje dhe Politika Publike"</i> <i>Evidenca 4.3. Paketa e praktikës profesionale;</i>
Konkluzione	<i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike", ka kualifikimin e duhur të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standarteve të mësimdhënies për këtë program studimi. Institucioni duhet të rishikojë përmbushjen e kriterit ligjor lidhur me mbulimin e ngarkesës mësimore për programin e studimit. GVJ nisur nga vlerësimi i DVV dhe takimeve në institucion, vlerëson se standardi</i>

	<i>përbushet kryesisht pasi personeli akademik efektiv për këtë program studimi mbulon më pak se 70% të ngarkesës totale mësimore dhe më shumë se 30% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK, gjë e cila është jashtë kriterëve ligjore.</i> <i>GVJ rekomandon që institucioni të përbushë përcaktimet ligjore për mbulimin e ngarkesës mësimore nga PAE në masën jo më pak se 70% të saj dhe mbulimin e ngarkesës mësimore në masën 30% nga PAK, duke sjellë kështu përmirësimin e efektivitetit të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe vëzhgimit të infrastrukturës në funksion të programit të studimit, u konstatua se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, kjo në varësi të numrit të studentëve si dhe në përputhje me fushën e programit të studimit. Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të programit të studimit, ka një sipërfaqe totale prej rreth 7154 m², ku ndër mjedise kryesore mund të përmendim: • 6 salla për leksione dhe 16 salla për seminare, me sipërfaqe 1854 m². • 2 salla për aktivitete promovuese, me sipërfaqe 282 m². • 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale - me sipërfaqe 100 m². • 1 sallë interneti – me sipërfaqe 45.5 m². • 2 salla biblioteke - me sipërfaqe 189.5 m². • 1 mjedis për fotokopje, librari me sipërfaqe 12 m². • 1 zyrë informacioni për studentët, me sipërfaqe 9 m². • 4 mjedise mbështetëse, me sipërfaqe 96 m² Fakulteti plotëson normativën e ndriçimit natyral, siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën, si dhe përbush detyrimet për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit. <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 2.29. Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të	GVJ konstaton se mjediset mësimore janë të pajisura me pajisjet e nevojshme elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, dhe



tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	konsiderohen të përshtatshme në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit. Sallat janë të pajisura me kompjuter, video-projektorë, internet, sistem fonie dhe sistem kondicionimi, duke mundësuar një proces teorik e praktik sipas metodave metodologjike bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 2.29. Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Pavarësisht se natyra e programit nuk kërkon atelie specifike, në FShS, ambientet e dedikura për procesin mësimor, plotësojnë kushtet për mësimdhënie. Ambientet e bibliotekës, konsiderohen të përshtatshëm për plotësimin e kërkesave të programit të studimit, nisur nga vetë natyra e këtij programi, njëkohësisht përdoret për të aksesuar informacion, për të përgatitur prezantime dhe detyra kursi, etj., ndërsa biblioteka përdoret si për aksesimin e literaturës fizike ashtu edhe asaj elektronike. <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ konstaton se në Fakultetin e Shkencave Sociale, aktualisht nuk ka një laborator IT. Fakulteti ofron një sallë interneti në bibliotekën e sotme, me 8 kompjutera për student, e cila ka poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme, dhe mund të shfrytëzohen nga studentët edhe jashtë orarit të mësimi, për realizimin e detyrave praktike. <i>Evidenca. Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve</i> <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Nga vizita në institucion dhe vëzhgimi i infrastrukturës, konstatohet se institucioni garanton kapacitetet dhe mjediset e nevojshme, për zhvillimin e veprimtarive praktike, të cilat lidhen kryesisht me përgatitje prezantimesh, detyra kursi, etj. Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të praktikës profesionale, mundësohen me qëllim aftësimin praktik e profesional të studentëve. <i>Evidenca 3.17. Lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale</i> <i>Evidenca 3.19 Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të DVV-së dhe vizitës në institucion ka konstatuar se Fakulteti i Shkencave Sociale ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies për programin e studimit. FShS dhe DShP për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit kanë nënshkruar një sërë marrëveshjes me institucione publike, biznese dhe Organizata. Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky

	<i>standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ pas shqyrtimit të syllabuseve dhe diskutimit me stafin akademik, dhe studentët, vlerëson se literatura bazë dhe ndihmëse, u prezantohet studentëve në syllabuset e lëndëve të cilat ndryshojnë e përmirësohen duke u përshtatur me nevojat dhe ndryshimet e tregut të punësimit. Sektori IT mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit për bibliotekën online. <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i> <i>Evidenca 2.26. Buxhetimi për pasurim të bibliotekës</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Shtimi i zërave të bibliotekës është një proces periodik, bazuar mbi kërkesat e departamentit dhe personelit akademik, sipas një plani të detajuar për këtë qëllim. Përditësimi i fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit inicohet nga personeli akademik, nisur nga nevojat e evidentuara në bazë të literaturës së nevojshme për lëndët e tyre. Gjithashtu në Rregulloren e Bibliotekës përcaktohet politika e pasurimit të saj për mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor nëpërmjet, blerjeve, dhuratave, projekteve dhe shkëmbimit midis bibliotekave. Kërkesa i përcillet drejtuesve të njësisë bazë/kryesore, dhe në bashkëpunim me Administratorin e njësisë kryesore, fillojnë procedurat për blerjen e literaturës së nevojshme. Për studentët dhe personelin është vënë në dispozicion biblioteka online. Gjithashtu institucioni ka një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës, sipas kërkesave të njësisë bazë, para fillimit të vitit akademik. <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17;</i> <i>Evidenca 2.26. Buxhetimi për pasurim të bibliotekës;</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 4.2. Programet mësimore të lëndëve;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve	Nga GVJ gjatë vizitës në institucion, 2 biblioteka mësimore: 1) salla multimediale me disa pose kompjuteri dhe 2) salla e leximit për

bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	studentët, me një sipërfaqe 189.5 m² vlerësohen si të përshtatshme, si në aspektin e kapaciteteve akomoduese (poste leximi dhe kompjuter) ashtu edhe në aspektin e fondit fizik të literaturës në dispozicion. Këto element garantojnë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Vlen të theksohet se aktualisht godina është në proces rikonstruksioni pasi po i shtohen dhe ambiente të dedikuara për bibliotekën. <i>Evidenca. Vizita në institucion, vëzhgimi i mjedisve;</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17;</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16;</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e FShS ofron literaturë mësimore për programin e studimit Master Profesional "Qeverisje dhe Politika Publike". GVJ konfirmon se biblioteka është e pajisur me fond fizik si tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, kryesisht në gjuhën shqipe. Fondi i bibliotekës përbëhet nga blerjet dhe dhurimet e materialeve me një fond prej 7343 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj. Aksesi në artikuj e revista shkencore, realizohet përmes bibliotekës elektronike, sipas adresave të dedikuara institucionale. Informatizimi i bibliotekës është bërë sipas sistemit të katalogimit cobiss. Pjesë e fondit të bibliotekës, janë edhe punimet e diplomave të studentëve apo proceeding books të konferencave të organizuara. Biblioteka vetëpasurohet në mënyrë të vazhdueshme falë edhe publikimit të revistave shkencore "Politikja" dhe "Puna Sociale dhe Politika Sociale". <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17;</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën;</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambjentet e dedikuara për studentë dhe jo vetëm, vërejtëm se pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online, të tilla si EBSCO dhe SAGE me akses pwr 5(pesw) vite. Gjithashtu nw kuadwr tw projektit Clean Score pwrfitoi njw marwvshje pqr abonim nw bibliotekwn online JSTOR. Kwto platforma mund të aksesohen nw ambientet e bibliotekës, si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies nw funksion tw programit tw studimit. <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019;</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17;</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën;</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa	Biblioteka e FShS-së që GVJ-ja vizitoi, është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.

kufizim për të gjithë studentët.	Nga biseda me studentët, rezultoi që ata e preferonin literaturën online në formatin elektronik, sipas orientimit të pedagogëve për lëndët që zhvillonin. <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019;</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17;</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve, në orarin 08:00-16:00, orar i cili është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Në sezonin e provimeve, biblioteka funksionon edhe përtej këtij orari. Nga vizita në mjediset e bibliotekës dhe zhvillimit të takimit me punonjësen e bibliotekës, konstatohet se kapacitetet ekzistuese janë të përshtatshme në raport me numrin e frekuentuesve të këtyre ambienteve . <i>Evidencë. Vizita në institucion, vëzhgimi i mjedisëve;</i> <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019;</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga biseda e GVJ me stafin e Departamentit të Shkencave Politike, ka një planifikim vjetor për blerjen e literaturave bashkëkohore për realizimin e programit të studimit për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës. Nga takimet e zhvilluara në insitucion dhe gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, u vu re se duhet të ketë një koordinim dhe bashkëpunim për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, i cili jo vetëm duhet ti përgjigjet një literature të përditësuar të viteve të fundit, por dhe të ketë një numër kopjesh të mjaftueshme për studentët e programit të studimit. Në aktet e brendshme të institucionit, studentët informohen me të drejtat dhe detyrimet e tyre mbi aksesin në bibliotekë. Pasurimi i fondit të bibliotekës bëhet përmes blerjes së librave (sipas kërkesës së departamentit), dhurimeve dhe abonimeve në biblioteka digjitale apo revista shkencore. <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019;</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.26. Buxheti i pwr pasurim tw bibliotekws</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën;</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17;</i>
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar studentëve dhe personelit akademik, u ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për procesin e mësimnxënies dhe mwsimdhwnies. Në dispozicion të tyre është biblioteka, si një ambient i dedikuar, i pajisur me tavolina pune, kompjutera dhe raftë librash. Biblioteka përbëhet nga fond fizik dhe elektronik si dhe nga aksesin në burime të jashtme, në formën e bibliotekës digjitale. Biblioteka aksesohet e koordinuar me oraret e procesit mësimor, aksesohet dhe në çdo kohë fondi elektronik i saj, përmes adresave zyrtare. Biblioteka ka një personel të dedikuar. Aktualisht, Godina e Fakultetit është në process rikonstruksioni, ku një kat i është dedikuar riorganizimit të ambienteve të bibliotekës. Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky standard përmbushet plotësisht.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të një sërë dokumentesh, GVJ vlerëson se sekretaritë disponojnë dhe administrojnë gjithë informacionin në format fizik dhe elektronik fizik në lidhje me studentët, nga regjistrimi deri në diplomim nëpër regjistra të standardizuar për IAL me të dhëna të përditësuara nga gjeneralitetet si datëlindja, atësia, deri tek shkolla e mesme nga kanë ardhur, data dhe viti i regjistrimit në programin e studimit që ndjekin, notat, datën e ç'rregjistrimit dhe transferimit për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera, aktivitetet e tyre, datën e diplomimit dhe kontaktet. Studentët aksesojnë informacionin përmes platformës së dedikuar e student. <i>Evidenca 1.10. Manual përdorimi i sistemit informatik e-student 2022;</i> <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018;</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, u njoh me bazën e të dhënave dhe dokumentacionin mbi personelin akademik, ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike". Zyra e Burimeve Njerëzore disponon dosjet e të gjithë stafit akademik dhe administrativ që prej aplikimit të tyre. Dosjet përditësohen me çdo dokument të fituar nga anëtarët e stafit përgjatë punës së tyre dhe dokumenti shtohet në dosje (p.sh një diplomë shtesë, një certifikatë, publikim/botim në revistë shkencore etj). Sistemi i UT-së për ruajtjen e informacionit të personelit, bazohet në arshivimin e dokumentacionit në formën hardcopy dhe elektronike dhe kjo ka rezultuar efektive. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018;</i> <i>Evidenca 2.21. Udhëzimi për dosjen e pedagogut;</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni, sistemin e menaxhimit elektronik e ka të organizuar në dy nivele. Së pari, nivelin e personelit (ku përfshin personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ) dhe së dyti niveli i studentit. Niveli i personelit mundëson administrimin siguron akses të dedikuar në informacione që lidhen me procesin mësimor dhe dokumentet e

	gjeneruara respektive, si prsh procesverbalet e vlerësimit. Ndërkohë për studentët, përmes e student mundësohet aksesit në materialet e leksioneve, literatures dhe në të gjitha zërat e programit të studimit, informacion që lidhet me lëndët, kreditet, mënyrën e vlerësimit etj. <i>Evidenca 1.8. Rregullore UT, pwr "Mbrotjtjen, pwrpunimin ruajtjen dhe sigurimin e tw dhwnave personale;</i> <i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Referuar takimeve të zhvilluara në institucion, mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit elektronik, vërehet se është kryesisht një komunikim me qëllim shkëmbimin e informacionit, mes dy niveleve të përfshirjes së tij, personelit dhe studentëve. Efikasiteti i sistemit të menaxhimit, konsiston në mundësinë e aksesit të informacionit në çdo kohë apo vend. <i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit elektronik dhe ai jo elektronik në institucion, ndihmon në monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik të personelit përgjegjës, për element që lidhen me procesin mësimor, kërkimin shkencor etj, si edhe mundëson prodhimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore që lidhen me performancën e studentit apo frekuentimin. Gjithashtu të dhënat e mbledhura mundësojnë gjenerimin e raporteve vjetore institucionale që u vihen në dispozicion organeve drejtuese, për procese strategjike të institucionit apo për procese të ndryshme institucionale. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e UT;</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet e lidhura me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme, publikohen në faqen e internetit të institucionit (www.unitir.edu.al), në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjatw vizitws nw institucion dhe takimeve me pwrfaqwsues tw njwsive kryesore dhe bazw, na u referua takimeve në fakultet, se faqja ëeb për Fakultetin e Shkencave Sociale është duke iu nënshtruar procesit të përditësimit të saj. <i>Evidenca extra nr. 5. Përditësim i Eëb-it FShS;</i>			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit është i kompletuar, dhe mbështetës në vijimësinë e aktiviteteve të instituconit për programin e studimit në proces vlerësimi. Sistemi i brendshëm për menazhimin, administrimin dhe publikimin e informacionit, mbështetet edhe përmes akteve të brendshme të institucionit sipas të cilave janë përshkruar detyrat dhe funksionet respektive përsa i përket mënyrës së administrimit të informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik apo financiar në nivel isntitucioni, njësie kryesor edhe njësie bazë. Në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik. GVJ vlerëson të përmbushur plotësisht këtë standart.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxheti financiar në nivel institucioni bëhet çdo vit akademik. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas cikleve dhe programeve të studimit. Raporti financiar i UT nuk pasqyron kosto të veçanta për Departamentin e Shkencave Politike apo për programin e studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike", por në nivel universiteti Planifikimi i financimit, realizohet në mënyrë paraprake për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. Planifikimi konsiston tek përcaktimi i nevojave financiare të njësisë bazë për realizimin e programit të studimit e përfundon tëk miratimi i tyre nga Bordi i Administrimit. Administratori i njësisë kryesore (fakulteti) harton çdo vit projekt buxhetin sipas kërkesave të njësisë përbërëse. Raportet financiare diskutohen në dekanat e më pas i përcillen Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës. Ndryshimet e mundshme të buxhetit të institucionit bëhen sipas procedurave të parashikuara në aktet e brendshme. Evidenca mbi të ardhurat dhe financimet e ndryshme tregojnë që institucioni ka siguruar të ardhura nga disa burime, që nga pushteti vendor deri tek donacione, aktivitete sigurose, fondacione etj. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FShS (Tabela 18);</i> <i>Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FShS 2022-2025.</i> <i>Evidenca 2.33. Buxheti i FShS 2023;</i>

Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se Plani financiar i UT si institucion që financohet nga buxheti i shtetit, përmban zërat sipas rregullave të një strukture kontabël ku përfshihen: Të ardhurat, të ndara në të ardhura nga tarifat e studentëve, nga shërbimet, nga projektet dhe donatorët. Plani i financimit të programit të studimit përfshihet në planin financiar të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe ky i fundit në atë të Universitetit. Plani i financimit të programit të studimit përmban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si orë mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative etj, si dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, projektet dhe çdo zë tjetër të nevojshëm. Në dokumentacionin mbi buxhetin, paraqiten elementët e lidhur me financimin e burimeve njerëzore, si për personelin akademik ashtu edhe për atë administrativ, shpenzimet operative për infrastrukturën (mirëmbajtjen dhe përmirësimin e saj), sikurse dhe shpenzimet për pasurimin e fondit të bibliotekës. <i>Evidenca. 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit; Evidenca. 2.32. Buxheti afatmeswm FShS 2022-2025; Evidenca 2.33. Buxheti FShS 2023; Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023; Evidenca. 1.18. VBA pwr miratimin e grantit pwr konferenca ndwrvkombwtare;</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Tiranës, si një institucion publik i arsimit të lartë, i nënshtrohet të gjitha detyrimeve, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Në dokumentacionin e përcjell nga IAL lidhur me buxhetin, duke e strukturuar në bazë të Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” pasqyrohet edhe raporti financiar në të cilin paraqiten të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera. Auditimi kryhet nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Universitetit të Tiranës, ku në përfundim të procesit lihen edhe rekomandimet përkatëse. Raporti financiar auditues, nuk përmban vetëm pasqyrat e gjendjes financiare, por edhe shpërndarjen e burimeve financiare <i>Evidenca 2.34. Raport auditit FShS;</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në Fakultetin e Shkencave Sociale, Administratori i Fakultetit raporton deri në nivel njësie bazë për realizimin e buxhetit të miratuar të vitit pasardhës. Realizimi i buxhetit bëhet edhe pjesë e analizës vjetore të njësisë si dhe monitorohet nga procesi i auditimit të brendshëm. <i>Evidencë 1.25. Plani Strategjik i UT 2023-2028; Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023; Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18);</i>

	<i>Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; Evidenca 2.33. Buxheti i FShS 2023;</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësishë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Pas vizitës në institucion dhe takimeve të zhvilluar, GVJ vëren se të dhënat financiare dëshmojnë se institucioni siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për gjenerimin e të ardhurave gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike", dhe për të ardhmen. Qëndrueshmëria financiare garantohej si nga të ardhurat nga tarifat e studentëve ashtu edhe mbështetja nga buxheti, duke qenë se IAL përgjegjëse për programin e studimit, është IAL publike dhe financohet edhe nga buxheti i shtetit. <i>Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18)</i> <i>Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; Evidenca 3.18.1. Raporti vjetor për vitin 22-23 dhe 23-24;(tab 21,22,23)</i>			
Konkluzione	GVJ duke e vlerësuar nga këndvështrimi i një institucioni që mbështetet nga buxheti i shtetit, vlerëson se UT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike" dhe mbështetjen e studentëve. Përmes identifikimit të nevojave, të cilat më pas bëhen pjesë e buxhetit vjetor të institucionit, realizohet dhe planifikimi. Për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të programit, do të këshillojmë që njësia bazë të aftësohet në proceset e financimit, shpenzimeve, detyrimeve financiare apo dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, për të garantuar edhe në këtë drejtim autonominë e njësishë bazë, sipas frymës së ligjit. Institucioni realizon në mënyrë periodike procesin e auditimit të brendshëm, përmes Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, pjesë e UT. GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

60

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të të dhënave të studentëve, vërteton se ato janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.436, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e ciklit të dytë. Po ashtu, edhe aktet rregullatore të institucionit të tilla si: Statuti dhe Rregulloret apo edhe vendimet e Senatit, pasqyrojnë procedurat sipas legjislacionit në fuqi dhe zbatohen edhe nga DShP. Kriteret pranuese në programin Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike", propozimi për numrin e kuotave kalojnë për miratim nga departamenti në dekanat, rektorat, senat akademik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore dhe biseda me studentët, GVJ konstaton se, institucioni respekton legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Informacioni mbi këto procedura publikohet në ëeb-in zyrtar të UT dhe FShS-së dhe sqarohet në institucion për çdo të interesuar. Studentët kanë mundësi të aksesojnë këtë bazë ligjore, në kohën që ndjekin studimet pranë këtij institucioni. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit-te-Tiranes-2022;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025;</i> <i>Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të ShP;</i> <i>Evidenca 3.6. Rrregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni zbaton politika dhe procedura të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomim të tij. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UI e duke siguruar një vlerësim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të ShP;</i> <i>Evidenca 3.6. Rrregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e	Informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimin, është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore. Institucioni shpall kriteret specifike të pranimin në programin e studimit (të publikura në faqen

kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	zyrtare të Universitetit të Tiranës dhe atë të Fakultetit të Shkencave Sociale. Kriteret e përgjithshme për pranimin në këtë program studimi është përfundimi i ciklit të parë të studimit. Për të ndjekur Programin e studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike", studenti duhet të ketë përfutur një diplomë të ciklit të parë Bachelor dhe ka grumbulluar 180 kredite ECTS. Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kriteret: • Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve (minimumi 3 vjet) të përputhshme në masën 60 % me trungun e lëndëve të ciklit të dytë; • Diplomë e arsimit të lartë e përfutur jashtë vendit e vlerësuar ekuivalente me diplomat e mësipërme sipas kuadrit ligjor në fuqi. • Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë; • Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfutura në programet e studimit të ciklit të dytë Në fund dhe fillim të çdo viti akademik, Institucioni vlerëson ndikimin e politikave aktuale të pranimit për studentët në të gjitha programet e studimeve, e konkretisht për programin Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike" <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-Universitetit-të-Tiranës-2022;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025;</i> <i>Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të ShP;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Evidenca. 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit;</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni, përpara fillimit të vitit të ri akademik, publikon në faqen zyrtare, informacionin e nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, përzgjedhjes së studentëve transferimit dhe njohjes të studimeve, të cilat janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore, të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: • me provim me shkrim; • me detyra kursi, projekte • i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi. Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të

	vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit . Në fillimin e vitit akademik, përgjegjësi i departamentit, koordinatori si dhe personeli akademik, ju prezantojnë studentëve aktet e brendshme të institucionit si dhe për çdo paqartësi që ata mund të kenë. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022;</i> <i>Evidenca 1.22. Kriteret e pranimit 2024-2025;</i> <i>Evidenca. 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Nëpërmjet kanaleve të mjeteve të komunikimit bëhet e mundur informimi i publikut të interesuar. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi organizimin e ditëve të informimit për të interesuarit konform një plani. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar. Referuar dokumentit të politikave të marketingut, kanalet më të shpeshta të promovimit janë postimet në faqen zyrtare të Universitetit, pjesëmarrja në panairë, llogaritë institucionale të rrjeteve sociale si dhe organizimi i konferencave apo veprimtarive të tjera shkencore. Gjithashtu në dispozicion të të interesuarve institucioni ka shpërndarë dhe broshura informuese. <i>Evidenca 3.16 Politika marketing</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, ka kuota të dedikuara për kandidatët me aftësi të veçanta, pakicave apo shtresave të marginalizuara. Për studentët me aftësi ndryshe institucioni mundëson përdorimin e mjediseve përmes marrjes së masave specifike si materiale të aksesueshme të përshtatshme. Për studentët me aftësi të veçanta në godinën e FShS-së është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme si ashensore për të lehtësuar lëvizjen e tyre. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është i angazhuar për tu dhënë ndihmën dhe kujdesin e nevojshëm studentëve me aftësi ndryshe, për mbarëvajtjen e procesit mësimor. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022;</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025;</i> <i>Evidenca 2.23. Politikat për mbështetje të studentëve;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Evidenca 3.13. Vendim për miratimin e kuotave të pranimit;</i> <i>Evidenca 3.14. vendim për miratimin e kriterëve të pranimit;</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ vlerëson se për çdo vit akademik, Institucioni publikon edhe kriteret e programeve të ciklit të dytë (Mp) për studentë të huaj që shfaqin interes. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjtat me aplikantët brenda vendit, por kuotat janë të dedikuara për këto kategori dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit.

	<i>Evidenca 3.13. Vendim për miratimin e kuotave të pranimit;</i> <i>Evidenca 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ pas takimeve të zhvilluara në institucion konstaton se institucioni mbështetur në VKM-në Nr. 39, datë 23.01.2019 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, ofron mundësi të pajisjes së studentëve me bursa apo reduktim të tarifave sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ky informacion ju ofrohet të interesuarve nëpërmjet faqes zyrtare të ëeb-it të UT, FShS, faqes zyrtare në facebook të FShS, sekreatrisë mësimore dhe nëpërmjet Zyrës së Karrierës. <i>Evidenca. 2.23. Politika për mbështetjen për studentët;</i>			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, ndjek dhe zbaton politika si edhe procedura të qarta, publike dhe të aksesueshme nga palët e interesuara për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për studentët e kategorive sociale të veçanta. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, por edhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se kandidatëve për studentë, që në fazën e parë të aplikimit, u ofrohet informacion lidhur me programin e studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike" ku përfshihen: plani mësimor (kurrikula), stafi akademik, koha e realizimit, koha e përgatitjes dhe e mbrojtjes së diplomës (provimit të përgjithshëm përfundimtar/mbrojtjes së tezës), si dhe kryerja e praktikës profesionale. Studentët e regjistruar, informohen nga sekretaria mësimore në lidhje me kurrikulën, orarin, sistemin e krediteve për të kaluar nga një vit në tjetrin. Koordinator i programit si dhe përgjegjësia e DShP organizojnë takime periodike me studentët e këtij programi për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për t'i informuar për çdo kërkesë dhe afat që ndikon në përparimin e tyre akademik. GVJ konfirmion se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e

	përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës, pwr praktikën profesionale dhe temën e diplomës. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Evidenca 3.11. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ vlerëson DShP i cili ndjek dhe harton procedura mbi njohjen e transferimet e krediteve dhe mobilitetin, i bazuar tek realizimi i procedurës dhe informimit të studentëve mbi këto procese. Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit shqyrtohet nga një komision ad hoc, në përputhje me rregulloren e programit të studimit. Sekretaria mësimore informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, sipas interesimit të tyre. Informacioni ndodhet edhe i publikuar në faqen ëeb të institucionit. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022;</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit,</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ konstaton se institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve të parashikuara në Rregulloren e Programit të Studimit, ku janë përcaktuar mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve, e drejta për të hyrë në provim pasi studenti ka ndjekur mjaftueshëm orët e leksioneve dhe seminareve, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimit. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit parashikohen në programet e lëndëve (syllabuset), duke ju dhënë atyre mundësi të plotësojnë njohuritë dhe sqarojnë paqartësitë gjatë dhe në fund të procesit mësimor si më poshtë: • me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; • me detyra kursi, projekte, poster; • i bazuar në një shumë llojshmëri formash vlerësimi. Format e kontrollit të vazhdueshëm të studentit janë: • Pjesëmarrje aktive në diskutime rreth tematikave gjatë zhvillimit të seminareve dhe aftësitë e shkathtësia për punën e pavarur në grup me 20% të lëndës; • Detyrë kursi me 20% të lëndës; • Provimi përfundimtar është provimi me shkrim që zhvillohet në fund të semestrit dhe përbën 60% të vlerësimit semestral të lëndës. Informimi i studentëve për të gjithë informacionin e mësipërm realizohet me komunikim të drejtpërdrejtë në auditor duke sqaruar çdo




	paqartësi që studentët mund të kenë. <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Evidenca 4.2 Programet mësimore (syllabuset);</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në fillim të vitit akademik, DShP informon studentët e regjistruar në programin e studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politika Publike" mbi procedurat e diplomimit bazuar kjo edhe në rregulloren e programit të studimit dhe rregullores për diplomat e ciklit të dytë të studimeve. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga stafi akademik dhe përgjegjësi i departamentit, dhe u konfirmua nga studentët që ky informacion ju ishte dhënë studentëve që në fillim të vitit. Dokumenti përmban shpjegime në lidhje me zgjedhjen dhe miratimin e temës, mënyrën e zhvillimit të udhëheqjes së punimit të diplomës, zhvillimin e seancave këshillimore, dhe mënyrën e organizimit të punimit të diplomës. Procesi i fundit është vlerësimi i punimit nga komisioni i vlerësimit dhe kriteret mbi ku bazohen. <i>Evidenca 1.9. Rregullore për diplomimin;</i> <i>Evidenca 2.11. Rregullore e diplomimit FShS;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ vlerëson angazhimin e Institucionit i cili kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm, mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të. Kryesisht studentët i përkasin programit të studimit Bachelor në Shkenca Politik i ofruar nga Departamenti i Shkencave Politike, por edhe nga disiplina të ngjashme. Oferta akademike për programin e studimit promovohet nga institucioni sipas bazës ligjore në fuqi. Vlen për tu përmendur iniciativa e njësisë bazë për të vijuar procesin e promovimit tek targeti i studentëve të ardhshëm të interesuar nëpërmjet broshurave informuese, faqes zyrtare të internetit të UT, FShS dhe rrjeteve sociale. Për informimin e studentëve mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të kujdeset dhe shërbimi i karrierës (web zyrtar https://fshs-ut.edu.al/ i UT, FShS_Shërbimi i Karrierës në FShS). <i>Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë;</i> <i>Evidenca 2.31. Ngritja e grupeve të punës për pranimet e reja në ciklin e I dhe të II të studimeve në FShS, për vitin akademik 24-25;</i> <i>Evidenca 3.10 Broshurë informative;</i> <i>Evidenca 3.16. Politika e marketingut;</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni u siguron studentëve të programit të studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike" informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit në fillim të çdo viti akademik. Institucioni ka përcaktuar rregullore dhe vendime senati për kriteret të detajuara për përparimin akademik, transferimin dhe njohjen e krediteve të fituara më parë, vlerësimin e dijeve deri në përfundim me rregulloren e provimeve e diplomimit. Informimi bëhet në fillim të vitit akademik përmes takimeve të organizuara me studentët, nga strukturat akademike të departamentit, kurse titullarët e lëndëve u shpjegojnë që ditën e parë të prezantimit të

	programit të lëndës mënyrën e vlerësimit. Po ashtu, broshurat dhe faqja online e institucionit sigurojnë informacione të detajuara edhe për tërheqjen e kandidatëve të mundshëm, me të cilët komunikohet nga afër në panaiet e organizuara dhe ditët informative. Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Informacioni lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike, si njësi bazë, që nga momenti që studenti fillon studimet. Fakulteti i Shkencave Sociale, nëpërmjet strukturave të veta, departament, staf akademik, koordinator programi dhe sekretari mësimore, siguron menaxhim të informacionit në lidhje me programin e studimit. Si një kanal i rëndësishëm i komunikimit dhe informimit është dhe faqja ëeb e Fakultetit, ku është i detajuar programi që po analizojmë, si: kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike”, i cili është 1 vit akademik, e që i përkojnë 60 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Edhe nga takimi me studentet u konfirmua se ata ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre. Gjithashtu në fillim të viti akademik, studentët informohen dhe u prezantohet silabusi nga lektori përgjegjës. Informacioni si orari apo njoftime të ndryshme shfaqen në monitorët informues në ambientet e FShS-së. <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit;</i> <i>Evidenca 3.6 Rrregullore e programit të studimit;</i> <i>Evidenca 4.2. Programet e lëndëve (syllabuset);</i> <i>Evidenca Vizita dhe takimet me studentët e programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ vlerëson se studentëve, nga institucioni, ju vihet në dispozicion dokumentacion dhe udhëzues të posaçëm për lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Studentët e programit të studimit Master Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike” informohen në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet strukturave përkatëse (koordinator programi, pedagogë, sekretari mësimore). Në fillim të vitit të ri akademik dhe çdo fillim semestri, studentëve u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës

	programi i lëndës/ve (syllabusi), ku janë specifikuar temat me literaturën e detajuar, format e vlerësimit të dijeve, etj. <i>Evidenca 3.6 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Evidenca 4.2. Programet e lëndëve (syllabuset);</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni përmes Shërbimit të Karrierës, Alumnit dhe Departamentit informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm (CV, letër motivimi, letër rekomandimi etj.) përmes aktivitete këshilluese të organizuara në mënyrë periodike. Institucioni ka krijuar një traditë me panaiet e punës me rrjetin e bashkëpunëtorëve me të cilët ndërmjetëson edhe për praktikatat profesionale, të cilat janë porta e parë e orientimit në tregun e punës. ZKK-ja ofron të gjitha llojet e shërbimeve dhe kujdesit ndaj studentëve si: - orientim për karrierën; - këshillim për karrierën; - informim dhe asistencë për aplikim për programet e studimit; - informim dhe orientim për tregun e punës. <i>Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ vëren se institucioni në funksion të realizimit të procesit mësimor, koordinatorja e programit të studimit, e cila koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e këtij programi, për të siguruar përmbyshjen e misionit dhe objektivave të tij, së bashku me sekretarinë mësimore dhe personelin akademik dhe ndihmës akademik, u venë në dispozicion studentëve informacion të përditësuar mbi gjithë komponentët e zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, si nëpërmjet komunikimeve elektronike, nëpërmjet e-mail-it zyrtar, ashtu dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me ta. Takimet në institucion, vizita në sekretarinë mësimore të programit të studimit; <i>Evidencë 2.9_Rregullore e sekretarisë mësimore;</i> <i>Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit).</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Strukturat brenda Fakultetit të Shkencave Sociale (sekretaria mësimore, zyra e informacionit dhe zyrës së këshillimit të karrierës.), si dhe njësia përgjegjëse e programit të studimit, ofrojnë informacionin e nevojshëm për studentët e interesuar. Gjithashtu, institucioni disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit për studentë, qofshin edhe në distancë duke ju mundësuar, informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët sipas viteve dhe semestrave, kreditet, rezultatet e marra (notat) etj. <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018;</i> <i>Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021;</i>

Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat formuese të secilës lëndë; kishin informacion të plotë e të hollësishëm për, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të tënxënit, Në dosje janë paraqitur informacion i plotë për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të tënxënit dhe mundësitë e punësimit. Në këtë proces angazhohen të gjitha strukturat përgjegjëse si personeli akademik dhe ndihmës akademik, sekretaria mësimore, zyra e infomimit dhe ajo e këshillimit të karrierës për studentë të gatshëm drejt tregut të punës. Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë takimeve në Sekretarinë Mësimore, GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit Master Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike”. Institucioni disponon dhe ka një sistem të menaxhimit të të dhënave të studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar, të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve. Sekretaria mësimore i ruan të dhënat lidhur me sa më lartë në: 1) Rregjistrin themltar të studentëve; 2) Rregjistrin e arritjeve akademike; 3) Rregjistrin e lëshimit të diplomave dhe Certifikatave. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon: Viti akademik 2022-2023 20 studentë; Viti akademik 2023-2024 11 studentë; <i>Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore; Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Evidenca 2.9. Neni 5_Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidenca 4.6; 4.9, Tab 21, 23_Të dhëna për regjistrimin, ecurinë,</i>

	<i>diplomimin dhe punësimin e studentëve)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni mban rregullisht statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. Ky numër përfshin transferimet nga programe paralele brenda IAL-së apo IAL të tjera brenda vendit, tërheqjen nga programi i studimit. <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018;</i> <i>Evidenca tab. 21_Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve;</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit venë në dispozicion, takimeve në sekretarinë mësimore, përgjegjësen e departamentit dhe koordinatoin e programit të studimit, GVJ konstaton se institucioni administron në mënyrë permanente dosjet e çdo studenti me të gjitha të dhënat e tij/saj në format elektronik dhe hard copy, që nga momenti i regjistrimit në këtë program studimi e deri në finalizim të tij (diplomim) që përbën njëkohësisht indikatorin dhe finalitetin e dimensionit profesional të Masterit Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike”, duke u shpalosur si sintezë e 1(një) viti studimi në qeverisjen, institucionet dhe politikat publike. Institucioni disponon dhe ka një sistem të menaxhimit të të dhënave të studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar, të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve Siguria dhe saktësia e të dhënave mundëson verifikimin e tyre në çdo kohë nga persona të autorizuar. <i>Evidenca 1.8. Rregullore UT për “Mbrotjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale</i> <i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ pasi shqyrtoi aktet e nxjerra nga institucioni si Rregullore, Manuale, Udhëzime, si dhe referuar sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave statistikore të studentëve, vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike i ka të pasqyruara këto në raportet periodike të tij për çdo vit akademik mbi veprimtarinë e tyre. Institucioni nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit mundëson menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, duke respektuar konfidencialitet dhe duke lejuar verifikimin e tyre në kohë reale prej personave të autorizuar bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT. <i>Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 3.18, 3.18.1. Raporti Vjetor 22-23 dhe 23-24 i Departamentit të Shkencave Politike;</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të	Institucioni harton raporte me të dhëna analitike mbi cilësinë në hyrje

hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	dhe në dalje të studentëve, si dhe ndjek punësimin e tyre përmes njësisë bazë dhe atyre mbështetëse, si ZKK, Alumni-t etj. Sipas të dhënave në të studentëve në programin Master Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike” në vitin akademik 2022–2023 janë regjistruar 20 studentë dhe në vitin akademik 2023-2024 janë regjistruar 11 studentë. Numri total i të diplomuarve është 14 për vitin akademik 2022-2023, dhe 9 për vitin akademik 2023-2024. Duke gjykuar se perspektiva e punësimit të studentëve përbën një faktor kyç në këtë drejtim, Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon pyetësor me studentët e FShS mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë e përmirësimit të tyre. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës angazhohet për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë, si dhe Departamentin në drejtimin e programit të studimit. <i>Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023;</i> <i>Evidencë 4.6 Tab 21_Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, Master Profesional “Qeverisja dhe Politikat Publike” tab 23.Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve të këtij programi studim;</i> <i>Evidencën 4.9. Të dhëna për punësimin real të studentëve (tab 4-6);</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UT, si institucion publik i arsimit të lartë, respekton detyrimin për të raportuar periodikisht të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, që sigurohen nga Sekretaria Mësimore. Sekretaria mësimore ruan dhe administron regjistrat e posaçëm dhe gjithashtu ruan të dhëna të format elektronik. Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës mbledh të dhëna mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë. ALUMNI evidenton të dhëna të punësimit të tyre pas diplomimit. <i>Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se në Statutin e

përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Universitetit të Tiranës janë parashikuar përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse si në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës, në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standarteve të Cilësisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Ata janë anëtarë me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të UT, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore si dhe në komisione të përhershme si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës ku zgjidhet edhe një student me mesatare mbi 9, si dhe një student në Këshillin e Etikës. Studentët kanë organizimin e tyre të dedikuar, në formën e Këshillit Studentor, si organizime të pavarura, me një mandat 2-vjeçar. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e UT;</i> <i>Evidenca 1.5. Kodi i etikës;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës;</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Angazhimi i studentëve është konkret, pasi ata janë vendimmarrës në disa struktura të universitetit. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies përmes Njësisë e Sigurimit të Cilësisë, bëhen pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. Rezultatet e këtyre instrumenteve trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje garantohej përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse, sikurse u shtjellua në Kriterin 1 më sipër. Po ashtu, vlerësimi i tyre mbi procesin akademik dhe performancës së stafit akademik kryhet edhe nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve në fund të semestrit ose përpara fillimit të sesionit të provimeve për të marrë vlerësimet e tyre, të cilat pasi diskutohen në departament pasqyrohen në analizat dhe raportet periodike. Institucioni ka miratuar një paketë instrumentesh të cilësisë. Pjesë e GVB-së për akreditimin e programit Master Profesional “Qeverisje dhe Politika Publike” është edhe një përfaqësues i studentëve, i cili u takua nga GVJ edhe gjatë vizitës. <i>Evidenca XXX Të dhëna tabelore për njësitë, studentët e angazhuar në SBC në nivel FSHS; Vendimi i dekanit për emrat e anëtarëve të GVB-së).</i> <i>Evidenca 3.18. Raport Vjetor;</i> <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore ne Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës;</i> <i>Evidenca Shkresa për ngritjen dhe miratimin e GVB;</i>

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga biseda e GVJ me studentët e programit të studimit Master Profesional "Qeverisja dhe Politikat Publike" del qartë se ata janë të familjarizuar dhe të angazhuar me çfarë aktivitetesh zhvillohen në Departamentin e Shkencave Politike dhe FShS. Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen e Departamentit realizohet kur ata ftohen në mbledhje ku ka për tu marrë ndonjë vendim që i ndikon ata. Rëndësia e angazhimit real të studentëve në vlerësimin e procesit akademik vlerësohet pozitivisht nga stafi akademik dhe drejtuesit që reflektonin rezultatet e anketimit të tyre. Studentët kanë të drejtën e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësiti e sigurimit të cilësisë. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni ka unifikuar kurrikulat, duke respektuar kuadrin ligjor dhe në këtë mënyrë edhe ngarkesën e studentëve. Gjithashtu, studentët përfaqësues në Senatin Akademik apo në komisionet e përhershme, shprehin darkordësinë e tyre në rastin e miratimit të programeve të reja apo riorganizimit të atyre ekzistuese. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e UT 2022;</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ vëren se në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e FShS-së përcaktohen procedura në rast ankese nga studenti. Studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pa llogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim te përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-UT 2022;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023(neni 46);</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në argumentet e evidentuara në pjesën përshkimore. Studentëve u mundësohet pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes nga Departamenti i Shkencave Politike. Ata ftohen në mbledhjet e Departamentit, kryejnë pyetësorë për procesin e vlerësimit të programit të studimit, si dhe në

	<i>fund të çdo lënde. Studentët e kanë të qartë edhe mundësinë e ankimit të rezultatit sipas rregulloreve institucionale, ndonëse ata kishin gjetur mirëkuptimin nga ana e pedagogut përgjegjës në rastet e përmirësimit të notës...</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se Institucioni ka krijuar strukturat dhe procedurat e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin ndaj studentëve si Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e informacionit, Sekretaria Mësimore, por edhe personeli akademik i këtij program studimi, me të cilët GVJ pati takime në institucion. Ato kryejnë funksione në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UT, për shërbimet e kërkuara nga studentët që nga regjistrimi, deri në diplomimin. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e UT-së-2022;</i> <i>Evidenca 1.10. Manual përdorimi i sistemit informatik e-student 2022;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Të gjitha shërbimet e strukturave administrative në UT, si dhe zyrave në shërbim të studentit janë tregues i një sistemi të posaçëm për informimin, këshillimin dhe përparimin e studentëve. GVJ konfirmon se studentët marrin gjithë shërbimet e kërkuara që nga informimi, këshillimi dhe asistimi për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për aktivitete e shërbime brenda e jashtë institucionit, për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore. <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-Universitetit-te-Tiranës-2022;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidenca 2.22 Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021;</i> <i>Takime në institucion me studentët, përfaqësues së zyrës së këshillimit dhe karrierës;</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit	Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit, dhe Karrierës dhe Alumnit, orienton studentët gjatë gjithë ciklit të studimit Master Profesional "Qeverisje dhe Politika Publike", për mundësitë e praktikave profesionale dhe mundësitë e punësimit përmes kontakteve individuale ose trajnimeve në grup. Zyra vepron edhe duke aktivizuar rrjetet alumni të të diplomuarve të kërrij programi studimi, për tu sjellë studentëve modele positive. ZKK-ja, rrjeti Alumni, por edhe njësia

mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	bazë, krijojnë mundësi bashkëpunimi me kompani për ofrimin e praktikave dhe punësimit për studentët, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, ëorkshop-e. Nëpërmjet ofrimit të mundësive për praktikat profesionale duke përdorur marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ana e institucionit, studentëve ju jepet edhe nje mundësi punësimi bazuar në aftësitë që ata demonstrojnë. Zyra e Këshillimit për Karrierë, ofron mbështetje për studentët, për organizimin dhe mbarëvajtjen e këshillimit akademik në funksion të tyre, për të sqaruar çdo paqartësi dhe për trajtuar vështirësitë me të cilat ai haset. Nëpërmjet realizimit të objektivave, mundësohet nxitja e frymës së bashkëpunimit mes institucionit dhe studentëve apo ish studentëve, për të promovuar institucionin dhe praktikat më të mira që ofron. <i>Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidenca 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative</i> <i>Evidenca 3.17. Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit për programin e studimit MP. QPP</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë ciklit të studimeve dhe ndjek punësimin e studentëve të diplomuar. Institucioni zotëron statistika mbi punësimin e studentëve të diplomuar në programet e studimit Master Profesional "Qeversje dhe Politika Publike" që ofron Departamenti i Shkencave Politike, ku në evidencat shoqëruese të RVB-së, gjetëm të specifikuar numrin e studentëve të punësuar në këtë program studimi. <i>Evidencë 1.26. Studimi i Tregut të Punës;</i> <i>Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidencë 4.6. Të dhëna për ecurinë e studentëve, nota mesatare në hyrje dhe dalje;</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni ka një dokumentacion që detajon kërkesat ligjore për përcaktimin e procedurave e strukturave të posaçme për informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve. Krahas dokumentacionit, ka struktura funksionale. Në sferën akademike, Departamenti dhe personeli akademik ndihmojnë për të orientuar e bashkëpunuar ngushtë me studentët Zyra e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës ofron shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të karrierës së studentëve dhe të punësimit. Këshilli Studentor, i cili mundëson përcjelljen e informacioneve të studentëve në strukturat vendimarrëse të institucionit dhe anasjelltas. Sekretaritetë mësimorë sigurojnë shkëmbimin e informacionit me studentët për notat, kreditet, transferimet, etj. Procesi i informimit është elektronik, por edhe pranë strukturave të posaçme të ngitura e të vëna në dispozicion të studeutëve. <i>Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht






				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ vlerëson se institucioni ka ngritur Qendrën Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional, e cila mundëson në nivel institucioni trajnime edhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies sipas fushës dhe moduleve respektive. Shqyrtimi nga GVJ i formateve të syllabuseve, tregon që stafet akademike përcaktojnë një larmi metodash mësimdhënie, në varësi të subjekteve që mbulojnë. GVJ konstaton se institucioni ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit, të cilat kanë objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxëniet si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme kjo edhe në mbështetje të Rregullores së NjBSC. Gjithashtu Universiteti i Tiranës, në strategjinë e zhvillimit 2022-2027 synon krijimin e rrugëve për të zbatuar metodat e reja dhe qasjet ndërdisiplinore më mësimdhënien dhe të nxënin. <i>Evidenca 1.20. Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional</i> <i>Evidenca 1.24. Strategjia institucionale për mesimdhënien 2022-2027 vendim-nr.24</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ vlerëson se institucioni ka ngritur një strukturë të dedikuar për zhvillimin e mekanizmave të vlerësimit periodik të aftësive të mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përmes pyetësorëve periodikë dhe fokus grupeve, analizon strukturën, cilësinë dhe ngritjen akademike të stafit, duke përfshirë të gjithë elementët e procesit mësimor. NJSBC i vuri në dispozicion GVJ gjatë takimit në Institucion formularë të aplikuar në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinator i programit

	vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik si përmes pyetësorëve të vlerësimit nga studentët për çdo lëndë në fund të semestrit, sikurse edhe mbi bazën e treguesve të aktivitetit të tyre shkencor. <i>Evidenca 1.6. Rregullore e organizimit dhe funksionimit e njësive të sig të brendshëm të cilësisë;</i> <i>Eviidencë 1.7. Rregullore e vlerësimit të performancës në punë, personel akademik dhe administrativ;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së;</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise;</i> <i>Evidenca 1.20. Vendim SA per ngritjen e qendrës virtuale te trajnimit dhe zhvillimit profesional;</i> <i>Evidenca 1.24. Strategjia institucionale per mesimdhënie 2022-2027 vendim-nr.24;</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ nga gjetjet e bëra dhe takimet me anëtarë të Njsbc, Përgjegjës Departamenti, personel akademik dhe studentë, konstaton se Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, përdor mekanizma formale për shqyrtimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimeve, nëpërmjet të cilave synon të rrisë ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve për rëndësinë e cilësisë. Gjithashtu institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV-së dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe ajo bazë, nëpërmjet NjsBC-së kryente monitorimin dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. Një element i rëndësishëm është dhe angazhimi i studentëve në këtë proces, fokus grupet, këto në funksion të përmirësimit të parametrave të cilësisë në të ardhmen si dhe bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese. Këto vlerësime (pyetësorë) zhvillohen dy herë në vit në fund të semestrit të 1,2 përpara nisjes së sesioneve të provimeve. <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e UT-2022;</i> <i>Evidencë 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik;</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në UT;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023;</i> <i>Evidencë 2.17. Raporte Periodike NjsBC;</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në UT, kryen vlerësimet dhe matjen e performancës në mënyrë periodike, më pas realizon përpunimin dhe analizimin e të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe personeleve respektive.





	Njohja me raportet e vlerësimit bëhet përmes publikimit, por edhe përmes prezantimit të gjetjeve në takime të njësive, me këshillin studentor, etj. <i>Evidenca 1.7. Rregullore për vlerësimin e performancës në punë personeli ndihmes akademik dhe administrative;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i> <i>Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023;</i> <i>Evidenca 2.20. Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik;</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Mbi bazën e analizës së rezultateve të anketimit (pyetësorëve), departamenti i Shkencave Politike, nxjerr konkluzionet dhe rekomandimet, plan masash, të cilat lidhen me përmirësimin e cilësisë për procesin e mësimdhënies, performancës së tyre, infrastrukturës etj. Promovimi i përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor rezulton nga bisedat me personeli akademik dhe studentët, të cilët përfshihen në projektet e pedagogëve të cilët kanë avancuar në karrierën e tyre përmes gradave Doktor, Prof.Asoc. dhe Profesor <i>Evidenca 1.7. Rregullore për vlerësimin e performancës në punë personeli ndihmes akademik dhe administrative;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i> <i>Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023,</i> <i>Evidenca 3.18/1. Raport Vjetor për vitin 22-23 dhe 23-24 Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit;</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht pasi Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, duke krijuar strukturat përgjegjëse si NJSBC dhe aktet rregullatore mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor. Në procesin e vlerësimit përfshihen edhe studentët, në plotësimin e pyetësorët dhe formularët e vlerësimit, stafet akademike dhe NJSBC. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

78

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni ka dhe ndjek një politikë të vetën për sigurimin e cilësisë e lidhur kjo me tërësinë e qëllimeve dhe parimeve, rregullave që institucioni përdor për të zbatuar vendimet dhe veprimet e veta gjatë procesit të sigurimit të cilësisë, Konferenca, seminare, shkolla verore dhe ditët e informimit; Ditët e zhvillimit profesional të cilat organizohen në bazë Fakulteti ose Departamenti. Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë në nivel institucional, strukturat përgjegjëse për sigurimin e standardeve të cilësisë janë: - Senati Akademik; - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë; - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Në nivel fakulteti, përgjegjës për sigurimin e standardeve të cilësisë janë: - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve; - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi; - Koordinatorët e programeve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bashkëpunon dhe me njësitë e tjera në institucion, për mbarrëvajtjen e procesit. Rezultatet bëhen publike si dhe janë objekt diskutimi në mbledhjet e njësive. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë, manualin dhe udhëzimet e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e Statutit dhe të Rregullores Bazë të UT, institucioni ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe Komisionin e Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë (KPSSC) për vlerësim në nivel institucioni, të cilët hartojnë politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë, shprehur edhe në Statutin e UT. NJSBC në nivel institucional kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel institucional, kurse NJSBC e FShS kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti bazuar në manualin dhe treguesit e hartuar nga NJSBC institucionale. NJSBC në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë ka përfshirë edhe studentët. Gjatë vizitës në institucion përgjegjësia e departamentit të Shkencave Politike dhe stafi akademik, konfirmojnë se rishikimet e programit të studimit (nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve,

	përfshirjen e disiplinave të reja, ndryshimi i kategorizimit të disiplinave, apo ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve) janë realizuar konform kuadrit ligjor në fuqi me propozime të cilat vijnë nga departamenti dhe me miratim nga senati deri në masën 20 % të programit. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve me studentët dhe vlerësimet e personelit akademik, si dhe në bashkëpunim me aktorë të komunitetit, si institucionet publike/ jo publike etj, ku studentët zhvillojnë praktikën profesionale, Departamenti ka qenë i nxitur për përmirësimet e nevojshme të programit të studimit. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave;</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike</i> <i>Evidenca. 3.15. Procedura për përmirësimin e kurrikulës të MP;</i> <i>Evidenca 4.2 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në Kreun V të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL dhe ka marrë Akreditim për 6 vite deri në Janar të 2029. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimet dhe matja e performancës kryhet në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personave respektive. Procesi i vlerësimit të jashtëm kryhet përmes procesit të akreditimit dhe vlerësimit të jashtëm të institucionit dhe programeve të studimit. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin	GVJ nga biseda me Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Politike me zv. Dekanen e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe personel akademik, gjykon se institucioni përdor tregues të ndryshëm të qartë dhe të matshëm si për mësimdhënie edhe kërkim shkencor për vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu, GVJ edhe nga shqyrtimi i DVV rezulton se në nivel institucioni dhe në nivel njësie bazë përdoren tregues të qartë e të matshëm për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e arritjeve apo mangësive të

e studimit.	programit të studimit si: monitorimi i syllabuseve nëse janë konform formateve të përcaktuara në VKM dhe Departamenti, rezultatet e studentëve në provime dhe në detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup, rezultatet e praktikës profesionale dhe të punimit të diplomave, si dhe rezultatet e punësimit të studentëve. Institucioni, nëpërmjet NjSBC-së, përdor metoda të tërthorta vlerësimi, si: - Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit); - Fokus grupe mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka në kompetencat e tij kontrollin dhe miratimin e raporteve 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. GVJ, nga dokumentacioni i paraqitur dhe diskutimet me stafin akademik dhe administrativ, konstaton se raportet e deritanishme janë të fokusuara në pasqyrimin e arritjeve dhe të dobësive të programit specifik. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Ruajtja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. Këto të dhëna mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NjBSC-së, çdo fillim viti akademik. Më tej ajo ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korrigjuese. Të dhënat, sugjerimet dhe masat korrigjuese shqyrtohen nga KPGSC-ja, dhe më pas i propozohen Senatit Akademik për miratim. <i>Evidencë 1.2. Statuti i 2018;</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i>			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni ka të ngritura struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre bazuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit. UT ka të hartuara dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ pas takimeve me Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Politike, personel akademik të angazhuar në programin që është në vlerësim, përfaqësues të NJSBC dhe Kurrikulave në institucion, konfirmon se ky program studimi ka kaluar në procese shqyrtimi që me hapjen e tij me 12.08.2009. Rishikimi i lëndëve, i syllabuseve dhe sigurimi i stafëve akademike të përshtatshme, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për realizimin e tij kanë kaluar nga departamenti në organet vendimmarrëse. Këto procese janë të dokumentuara në proces-verbalet e mbledhjeve dhe në raportet periodike vjetore të Departamentit të Shkencave Politike, të FShS, të NJSBC, ku pasqyrohen arritjet, problematikat dhe masat për kapërcimin e tyre për të siguruar përmirësimin e programit të studimit, cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve dhe vlerësimit të stafit akademik. Monitorimi i realizimit me korrektësi të programit Master Profesional "Qeverisje dhe Politika Publike" realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit dhe nga njësitë e mësipërme dhe u bëhen të njohura autoriteteve drejtuese të FShS. Bazuar në këto të dhëna përcaktohen edhe objektivat e programit të studimit për vitin pasardhës akademik. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;</i> <i>Evidenca 1.6.1. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike;</i> <i>Evidenca 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe	Çdo fillim viti akademik asambleja e personelit akademik të DShP diskuton në lidhje me programet e studimit që mbulon duke përfshirë edhe programin Master Profesional "Qeverisje dhe Politika Publike" dhe ka propozuar ndryshimet e nevojshme, sikurse, duke dokumentuar formalisht ndryshimet e bëra në kurrikulën e tij. Raportet e analiza e ecursisë së programit të studimit me synim adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim janë periodike dhe të vazhdueshme. Institucioni ka të gjitha kapacitetet për të realizuar matje

kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	sasiore e cilësore për të përmbushur sa më sipër. Po ashtu pasqyrohen rezultate e avancimit të stafit akademik, të pjesëmarrjes së tyre në veprimtari kërkimore shkencore, publikimeve dhe projekteve të Departamentit të Shkencave Politike, apo Fakultetit të Shkencave Sociale. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL, konstatoi që instrumenti i përdorur është i mjaftueshëm për të siguruar një vlerësim sa më holistik dhe të besueshëm në përputhje dhe me specifikën e fushës akademike të programit të studimit, si dhe të mundsohet përdorimi periodikisht i tyre. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësive në UT;</i> <i>Evidenca 2.16. Analiza vjetore e punës së FShS 21-22, 22-23;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i> <i>Evidenca 3.15. Procedura për përmirësimin e kurrikulës së programit Mp;</i> <i>Evidenca 3.18/1. Raporte vjetore 22-23 dhe 23-24 të DShP;</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe takimeve në institucion, konstatuam se për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit e konkretisht të programit Master Profesional "Qeverisje dhe Politika Publike" që kemi në analizë. krahas formave të larmishme të përmendura më sipër, kryhet edhe nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit. Gjatë takimeve në institucion me GVB dhe përgjegjësen e departamentit na konfirmuan të dhëna të mbledhjeve në departament për ecurinë e procesit mësimor, vlerësimi paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi i departamentit sipas formatit të standardizuar; mentorimi për mikrotezën e diplomimit, apo dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës profesionale. Një praktikë e mirë konsiderohet raporti vjetor i departamentit i cili përfshin të dhëna përshtetëse dhe sasiore të hollësishme mbi çështje që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, vetëvlerësimin e stafit akademik, rezultatet e arritura të studentëve, financimi i aktiviteteve të zhvilluara dhe kërkimi shkencor, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaritë shkencore etj. GVJ u informua gjatë takimit me personelin akademik dhe Përgjegjësen e DShP, si edhe studentet se në kuadër të përmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale. Keto metoda të drejtpërdrejta përfshijnë:
	-Vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, ku bën pjesë dhe ky program i studimit - Vlerësim të didaktikës, kurrikulës, leksioneve, syllabuseve, literaturat e përdorura -të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të

	studentëve; Ato analizohen dhe miratohen në departament në fillimin e vitit akademik. <i>Evidencë. Takimi me anëtarë të GVB-së, zyrra e kurrikulave; personel akademik;</i> <i>Evidencë 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës për personelin akademik;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.18. VBA Për miratimin e programit të grantit për konferenca ndërkombëtare;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ nga biseda me drejtues të institucionit, rezultoi se në nivel institucioni edhe në nivel njësie bazë përdoren edhe metoda të tërthorta për vlerësimin e ecures dhe mbarëvajtjen e programit të studimit si: monitorimi i syllabuseve (programi i lëndëve) nëse janë konform formateve të përcaktuara nga VKM dhe Departamenti, rezultatet e studentëve në provime dhe në detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup, rezultatet e praktikës profesionale dhe të punimit të diplomave, si dhe rezultatet e punësimit të studentëve. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë, aktualisht i përbërë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni Sigurimit për vlerësim institucional, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e parametrave të cilësisë në gjithë veprimtarinë mësimore e kërkimore – shkencore të Institucionit, duke u bazuar në Standardet shtetërore të cilësisë, si dhe në Manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. Institucioni, nëpërmjet NJSBC-së, përdor metoda të tërthorta vlerësimi, si: ▪ Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit); ▪ Fokus grupe (në muajin dhjetor) mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se UT, ka siguruar vlerësimin periodik të jashtëm nga ASCAL për akreditimin institucional dhe atë të programit të studimit. Departamenti i Shkencave Politike ka kryer vlerësimin e brendshëm dhe zbaton sistemin e brendshëm për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë përmes njësive të posaçme si NJSBC, Drejtoria e Kurrikulave dhe Koordinatorit të programit të studimit. UAMD ka ngritur njësi si NJSBC në nivel institucional dhe të FSHPJ dhe ka miratuar e zbaton rregulloren e saj për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë që pasqyrohet në raportet periodike.

	Po ashtu, Drejtoria e Kurrikulave monitoron programin e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit, duke siguruar që syllabuset t'i kenë pasqyruar saktë këto komponentë dhe pedagogët t'i zbatojnë ato në mënyre rigorozë. Studentët përmes pyetësorëve sjellin vlerësimet e tyre për arritjen e synimeve të programit të studimit. Po ashtu, edhe përshtypjet e bashkëpunëtorëve të institucioneve ku studentët bëjnë praktikën profesionale, të evidentuara në raportet e vlerësimit të studentëve, konfirmojnë dijet që ata kanë marrë përmes këtij programi studimi. Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi VI.4				
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin si Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e NJSBC, vlerëson se institucioni i ka të parashikuara politikat dhe procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë. Po ashtu, gjatë vizitës në institucion konfirmuam se këto politika zbatohen përmes një procesi të përfshirjes së strukturave të brendshme si NJSBC, Drejtoria e Kurrikulave, Departamenti me stafin e tij, studentët apo aktorët e jashtëm. Universiteti i Tiranës ka hartuar dhe zbatuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si pjesë e strategjisë së saj. Gjithashtu, në dokumentet themelore si Statut, Rregullore, Strategji e Universitetit, janë të parashikuar strukturat përgjegjëse për realizimin e procedurave të brendshme të cilësisë dhe garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar në këtë proces. Realizimi i instrumenteve të matjes së cilësisë si pyetësorë, fokus-grupe, anketa, formularë janë mekanizma që sigurojnë përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Programi i studimit ka kryer disa ndryshime në masën 20% në vitin 2023, 2014, si rezultat i konsultimit të departamentit dhe kërkesave të studentëve për përshtatshmërinë e tij me tregun e punës. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidencë 1.3_Rregullore e UT;</i> <i>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023;</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilesise ne UT;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.11Manuali i cilesise;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i>			
Kriteri 2. Institucioni përcakton	GVJ vëren se Institucioni në aktet e veta rregullatore përcakton			

përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	qartësisht detyrat, njësitë, stafet akademik dhe ndihmësakademi, studentët dhe institucionet me të cilat ka marrëveshje si aktorë të angazhuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Detyrat konkrete janë të përcaktuara dhe të specifikuara në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NJSBC, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politike dhe duke kërkuar vlerësimet periodike të studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, garanton këtë proces. Në këtë kuadër personeli akademik përgjegjës për mbikqyrjen e praktikave, luan rol kyç në manaxhimin e marrëdhënieve midis aktorëve të brendshëm edhe të jashtëm në realizimin e praktikës profesionale dhe për të marrë një vlerësim nga ta për cilësinë e programit të studimit. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018;</i> <i>Evidencë 1.3_Rregullore e UT;</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Nga vizita në institucion, GVJ konfirmon se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Master Profesional "Qeverisje dhe Politika Publike" janë të përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm të FShS. Drejtuesit e FShS dhe DShP kanë rolin kryesor në vendimmarrjet që lidhen me programin e studimit; personeli akademik është i angazhuar në çdo komision monitorimi si dhe jep opinionin e tij për përshtatjet në kurrikula dhe në pjesën akademike të programit të studimit. Studentët përfshihen në anketime të ndryshme ku shprehin opinionin e tyre si dhe grupe të veçanta ad hoc kanë edhe përfaqësuesin e tyre. Këto rregulla proceduriale janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UT dhe të provuara edhe në RVB për këtë program studimi, ku ekipi përbëhej nga pedagogë të Departamentit, të stafit administrativ dhe studentëve. <i>Evidencë 1.3_Rregullore e UT;</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit GVJ konfirmon se ato respektojnë etikën dhe integritetin akademik të personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në Departamentin e Shkencave Politike. Sikurse u diskutua me përgjegjësen e Departamentit dhe përfaqësues të NJSBC-së, për çdo vërejtje konkrete në adresë të stafit akademik që mund dalë nga procesi i vlerësimit, ata kontaktohen veçmas duke shmangur çdo keqkuptim për këtë proces. Po ashtu, edhe vlerësimet e studentëve janë anonime, për të siguruar çdo qëndrim negativ ndaj kritikave të tyre. Specifikisht këto standard referohen në Rregulloren e NJSBC në UT dhe Kodin e Etikës. <i>Evidenca 1.5. Kodi i etikës;</i>

	<i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve te cilësisë;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë shqyrtimit të DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton përfshirje të drejtpërdrejtë të bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm me proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, në nivel programi studimi. Gjithsesi, personeli i jashtëm akademik, i angazhuar në programin e studimit, sikurse dhe ky proces vlerësimi i jashtëm që po i nënshtrohet programi për herë të parë, janë element që ndikojnë në përfshirjen e aktorëve të tjerë në procesin e sigurimit të cilësisë. Bashkëpunëtorët apo ekspertët e jashtëm, të cilët në rastin e Departamentit të Shkencave Politike janë edhe të diplomuarit e tij, kanë dhënë vlerësimet e tyre si për praktikën e studentëve, ashtu edhe për tematikën të lidhura me programin e studimit gjatë aktiviteteve ku ata janë ftuar në Fakultetin e Shkencave Sociale. <i>Evidenca 1.25. Plani strategjik i UT per zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023;</i> <i>Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023;</i> <i>Evidenca 3.19. Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimit;</i>			
Konkluzione	GVJ konfirmon se institucioni përfshin në proceset e SBC-së të programit të studimit njësitë akademike si NJSBC, Drejtorinë e Kurrikulave, Departamentin e Shkencave Politike, personelin akademik dhe ndihmës akademik, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm me të cilët ka marrëveshje institucionale. Palët e interesuara si stafet akademike, ndihmës akademike, studentët apo të tjerë bashkëpunëtorë informohen në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre përmes takimeve, raporteve, aktiviteteve të organizuara në FShS, Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të	GVJ vëren se sistemi i sigurimit të standardeve të cilësisë në UT funksionon në bazë të dokumenteve dhe rregullave institucionale, të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Njësia kryesore në fund të çdo viti akademik harton Analizën Vjetore të punës. Të dhënat bëhen publike dhe të aksesueshme për studentë dhe palë të tjera të interesuara, si dhe në

interesuarit.	faqen zyrtare të UT. <i>Evidenca 1.2. Statuti i UT;</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT;</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë;</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024;</i> <i>Evidenca 3.18. Raporte vjetore të DShP;</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ vlerëson se në rregulloren e NJSBC janë parashikuar mënyrat e publikimit të rezultateve të vlerësimit dhe garantimin e parimit të lirisë dhe etikës akademike. Për zhvillimin e pyetësorëve respektohet parimi i anonimatit dhe rekomandimet dhe sygjerimet e dhëna nuk çenojnë parimin e autonomisë akademike. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentave të dosjes së vetëvlerësimit, të gjithë pyetësorët e plotësuar janë përpunuar, me metoda cilësore dhe sasiore, në varësi të llojit të pyetjes. Këto raporte vlerësimi kanë si synim jo vetëm evidentimin e gjendjes aktuale të cilësisë në institucion, por edhe të mënyrës së ndërhyrjes dhe marrjeve të masave, sipas të dhënave të përpunuara. Edhe pse nuk është paraqitur një dokument për marrjen e një mase konkrete, të dalë nga këto vlerësime.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit të vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se analizat periodike dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë, mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Stafi akademik dhe studentët e programit të studimit Master Profesional “Qeverisje dhe Politika Publike”, gjatë takimeve me GVJ-në, shprehën gatishmërinë dhe vullnet të mirë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, nisur nga analiza vjetore e punës që vetë departamenti hartonte, por edhe më gjerë nga rekomandimet e mundshme të vlerësimit të jashtëm nga ASCAL. <i>Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik dhe studentët e programit Master Profesional “Qeverisje dhe Politika Publike”.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit, avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe vlerësimi institucional. Fakulteti dhe departamenti organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura dhe përmirësimet e mëtejshme. Njëkohësisht, personeli është në dispozicion në ditë dhe në orare të ndryshme për studentët. Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë: -Informimi i stafit për proceset e vlerësimit; -Informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit;

	-Përfshirja e studentëve në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e performancës.			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion vlerëson se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit përfshijnë të gjithë aktorët e interesuar, strukturat, stafet akademike dhe studentët e bashkëpunëtorët e jashtëm. Politikat zërthehen në aktet e brendshme të institucionit por edhe në strategjinë apo planin e zhvillimit të tij. Për çdo raport vlerësimi, sipas gjetjeve respektive duhet të publikohet edhe plani i masave të nevojshme për tu ndërmarrë. Institucioni organizon veprimtari trajnuese dhe ndërgjegjësuere për rëndësinë dhe efikasitetin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Qeverisja dhe Politikat Publike”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”, Fakulteti i Shkencave Sociale

a. Pikat e forta dhe afirmime

1. Staf akademik i kualifikuar me eksperiencë kërkimore dhe praktike, duke garantuar cilësi në mësimdhënie (Standardi I.2, Kriteri 1–3).
2. Kurrikul e strukturuar mirë dhe e përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe me Sistemin e Bolonjës (Standardi I.2, Kriteri 2–3).
3. Bashkëpunime të qëndrueshme me institucione publike dhe organizata partnere që pasurojnë përvojën praktike të studentëve (Standardi I.3, Kriteri 2–3).
4. Metoda bashkëkohore mësimdhënieje dhe kërkimi, të cilat i japin studentëve aftësi të aplikuara (Standardi III.1, Kriteri 2).
5. Mbështetje institucionale për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e programit (II.2 – Kriteri 1 për cilësinë dhe tek I.2 – Kriteri 1,2 për kapacitetet e përgjithshme).

b. Pika të dobëta

1. Mosmbulimi i plotë i ngarkesës mësimore nga PAE sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, ku aktualisht stafi akademik efektiv mbulon më pak se 70% të ngarkesës mësimore të programit të studimit, dhe stafi akademik me kontratë mbulon më shumë se 30% të ngarkesës mësimore. (Standardit IV.1, kriteri 2)

Rekomandime

1. Rekomandohet që institucioni të përmbushë përcaktimet ligjore për mbulimin e ngarkesës mësimore nga PAE, në masën jo më pak se 70% të saj dhe mbulimin e ngarkesës mësimore jo më shumë se masën 30% nga PAK, duke sjellë kështu përmirësimin e efektivitetit të procesit mësimor.
2. Sugjerohet rritja e aplikimeve në projekte Erasmus+ dhe programe të tjera rajonale.

Conclusions of the External Evaluation of the Second Cycle Study Program Master Professional in "Governance and Public Policy" offered by the Higher Education Institution "University of Tirana," Faculty of Social Sciences

a. Strengths and Affirmations


1. The program is supported by a qualified academic staff with both research and professional experience, ensuring the delivery of high-quality teaching and learning (Standard I.2, Criteria 1–3).
2. The curriculum is well-structured, aligned with labor market demands, and fully compatible with the Bologna Process framework (Standard I.2, Criteria 2–3).
3. The program benefits from sustainable collaborations with public institutions and partner organizations, which significantly enrich students' practical training and professional exposure (Standard I.3, Criteria 2–3).
4. The implementation of modern teaching and research methods enhances students' applied skills and strengthens their professional preparedness (Standard III.1, Criterion 2).
5. Institutional support mechanisms for quality assurance and program development are evident, both in relation to quality assurance structures (Standard II.2, Criterion 1) and in terms of broader academic capacities (Standard I.2, Criteria 1–2).

b. Weaknesses

1. Incomplete coverage of the teaching workload by full-time academic staff (PAE), as required by current legal provisions. Currently, full-time academic staff cover less than 70% of the total teaching load of the study program, while contracted academic staff (PAK) account for more than 30%. (Standard IV.1, Criterion 2)

Recommendations

1. It is recommended that the institution fulfill the legal requirements concerning the distribution of the teaching workload, ensuring that at least 70% is covered by full-time academic staff (PAE), and no more than 30% by contracted academic staff (PAK), thereby enhancing the effectiveness of the teaching process.
2. It is suggested to increase participation in Erasmus+ projects and other regional programs.



FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X